



Nga i paragjykuar në model zhvillimi, arsimit profesional po ndryshon të ardhmen e të rinjve

Faqe 6



Si të gjelesh partnerë biznesi jashtë vendit për të eksportuar

Faqe 6



Mozaik i jetës rurale - Historia e Florës nga Puka

Faqe 10



AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit mars 2023

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 458
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

ULLINJTË DHE VAJI I ULLIRIT NË SHQIPËRI

SHQIPËRIA MUND TË EKSPORTOJË VAJ ULLIRI TË CERTIFIKUAR ORGANIKISHT ME CILËSI TË LARTË.

AKTUALISHT KJO PO NDODH TREND NË BRITJE

Prodhimi i vajit të ullirit traditë e vjetër në Shqipëri, por në ekonominë e re të tregut ka fituar vëmendje të shtuar si një potencial i rëndësishëm për gjenerimin e të ardhurave dhe sigurimin e punësimit

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC në fokus mbështetjen e agrobiznesit dhe zhvillimin rural, si sektorët potencialë të nxitjes së punësimit dhe agroturizmit



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2

PUNËSIM

Zhvillimi i aftësive profesionale i bën të rinjtë të përshtatshëm me tregun e punës

Faqe 2



Në 24 orë 40% e totalit të aplikimeve të 2022-shit, Krifca për ATSH-në: Rritje e besimit të fermerëve tek Skema Kombëtare



Faqe 2

HISTORI SUKSESI



Fermeri në Boboshticë, implementon në bujqësi dijet e marra në emigrim

Faqe 7

KËNDI I EKSPERTIT

- Këshilla për fermerët si të zgjidhni hibridin më të mirë të misrit Fq.11
- Mesazhe për prodhuesit e perimeve Fq.11
- Efekti i përdorimit të ushqyerit të balancuar të gjelit të detit në sistemin ekstensiv Fq.12
- Kujdesi dhe të ushqyerit e mëshqerrave Fq.12
- Kalendari bujqësor, muaji prill 2023 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

SHKËMBIME TREGTARE

Trendi eksportive bujqësore shqiptare jehonë në mediet prestigjioze ndërkombëtare



Faqe 2

RISI ALBANIA

MBËSHETJE NË BUJQËSI

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC në fokus mbështetjen e agrobiznesit dhe zhvillimin rural, si sektorët potencialë të nxitjes së punësimit dhe agroturizmit

Mbështetja jonë për zhvillimin ekonomik në Shqipëri përfshin edhe agrobiznesin dhe zhvillimin rural. Kështu u shpreh Ambasadorja e Zvicrës në Shqipëri, Ruth Huber gjatë një vizite që zhvilloi në pikën e agrobiznesit Mrizi i Zanave në Lezhë.

Delegacioni nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC - bashkë me partnerët e saj nga GIZ Albania - zhvilluan një ndalesë të këndshme tek Mrizi i Zanave Agroturizëm ku diskutuan me sipërmarrësin Altin Prenga, mbi çelësin për një ndërmarrje të suksesshme agroturizmi.

"Jam e impresionuar me cilësinë e lartë të produkteve vendase dhe potencialin për krijimin e vendeve të punës përmes përpunimit të ushqimeve dhe turizmit rural" - tha Ambasadorja Huber. Altin Prenga është një prej atyre që finalizoi idenë e tij gjeniale për një restorant mes natyrës, ku çdo gjë prodhohet në fshat. Nëse do të investosh sot në agroturizëm, veç të tjerash të duhet me siguri edhe një

bisedë me Altin e Mrizit, pionierin e një modeli të ri biznesi aq shumë të domosdoshëm për të krijuar zhvillim të qëndrueshëm në zonat rurale. Modeli i kësaj sipër-

Si kombinim elastik mes turizmit dhe bujqësisë, formula e agroturizmit ka rezultuar e suksesshme, duke garantuar treg të sigurt për fermerët e zonave rurale,



marrje ndërthurur me artin e tij të kuzhinës, e ka bërë Shqipërinë të njohur në të gjithë botën dhe ka krijuar qindra vende pune për komunitetin lokal. Janë pikërisht këto investimeve në Agroturizëm që po kthehen nga viti në vit në një nga sektorët më të rëndësishëm në vend për ndikimin në ekonominë lokale.

zbutje të varfërisë për familjet e angazhuara në punët e brendshme apo të zinxhirit të furnizimit në këto njësi. Ndaj dhe fokusi i qeverisë në bashkëpunim me donatorët është nxitja e këtij sektori me imapkt frenimin e hemorragjisë së emigracionit dhe zhvillimin e zinxhirit prodhues.

Zhvillimi i aftësive profesionale i bën të rinjtë të përshtatshëm me tregun e punës

Zhvillimi i aftësive profesionale i bën të rinjtë të përshtatshëm me tregun e punës. Përfaqesues të delegacionit nga Agjencia Zvicerane për

lartë studentësh - përfshirë vajza janë angazhuar në këtë projekt.

Gjithashtu projekti ka krijuar lidhje më të ngushta me

Karrierës.

Zyrës e Këshillimit të Karrierës në Bashkinë Tiranë, është një element i rëndësishëm tashmë që po orienton siç duhet të rinjtë drejt tregut të punës. Çdo person që paraqitet, merr përgjigjet për shërbimet e kërkuara dhe orientohet, sipas nevojave, në sektorët përkatës.

Në këto mjedise ka hapësira të dedikuara për të zhvilluar takime dhe konsultime me punëdhënës, punëkërkuar të papunë apo për të bërë dhe intervista pune të përbashkëta.

Falë kësaj zyre të rinj, të cilët nga punëkërkuar të papunë që ishin më parë, sot janë përfutur nga programet e ndryshme që zyra i orienton.

Stafi i kësaj zyre i inkurajon të rinjtë që dëshirojnë të bëhen pjesë e këtyre programeve që të aplikojnë dhe të sigurojnë një të ardhme më të mirë, jo vetëm për veten, por edhe për bashkëmoshatarët e tyre që nesër mund t'i punësojnë.

Investimet në Zyrat e Këshillimit mundësojnë akses më të madh në shërbimet e punësimit, si dhe orientim për kurset e aftësimit profesional, me qëllim integrimin e shpejtë në tregun e punës.

businesset: kompania Madish aktualisht ofron 15 vende praktikantësh dhe promovon në mënyrë aktive të mësuarit e bazuar në punë.

Fokus i projektit është punësim sa më të lartë për studentët në sajë të përgatitjes dhe kredencialeve më të mira, ndërsa inovacioni dhe digitalizimi në mësimdhënie janë prioritet i këtij projekti.

Për nxitjen e punësimit të të rinjve kontribut po jep edhe zyra e Këshillimit të



Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, së bashku me Ambasadorën e Zvicrës në Shqipëri Ruth Huber vizituan Shkollën e mesme profesionale "Hamdi Bushati" në Shkodër, si dhe kompaninë e tekstileve Madish - një nga partnerët e shkollës.

Mbështetja zvicerane përmes projektit Aftësi për Punë S4J ka sjellë një proces transformimi dhe disa ndryshime në ofertën e shkollës:

Kështu një numër më i

Në 24 orë 40% e totalit të aplikimeve të 2022-shit, Krifca për ATSH-në: Rritje e besimit të fermerëve tek Skema Kombëtare

Skema Kombëtare e mbështetjes në Bujqësi po fiton çdo vit e më shumë besimin e fermerëve të cilët kanë gjetur mundësinë për të përparuar në sipërmarrjet e tyre në të gjithë sektorët.

Kështu deklaroi për ATSH-në, ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, teksa tha se, "këtë fakt e tregon edhe numri i aplikimeve në 24 orët e para të hapjes së thirrjes për Skemën Kombëtare të këtij viti".

"Sipas statistikave zyrtare deri tani ka shkuar në 22 mijë numri i fermerëve që kanë aplikuar për të përfutur nga Skema Kombëtare e mbështetjes në Bujqësi 2023", u shpreh Krifca.

Ministrja tha se, kjo shifër është rreth 40% e numrit total të aplikimeve të regjistruara në vitin 2022, që ishin 49 mijë.

Nga shifrat zyrtare të publikuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural rezultojnë se Korça është qarku që regjistron

numrin më të lartë të aplikimeve me 3512 aplikime, ndjekur nga Fieri dhe Vlora me 3343 dhe

prej 1 679 813 litra naftë. Skema kombëtare ofron nëntë masat mbështetëse, me



2187 fermerë aplikantë.

Statistikat tregojnë se skema e naftës falas ka tërhequr interes të lartë, pasi rezultojnë se vetëm në ditën e parë kanë aplikuar 7676 fermerë nga 12 qarqet e vendit.

Aplikimet e ditës së parë janë kryer për një sasi naftë

zero dokumente dhe zero kosto dhe që mbulon pothuajse gjithë sektorët: blegtori, bletari, bimë mjekësore, ferma organike, certifikim GlobaGAP.

Fermerët kanë afat të aplikojnë për mbështetje në Skemën Kombëtare 2023 deri në datën 11 prill.

Aplikimet mund të kryhen online përmes portalit e-Albania në linkun: <https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx...> apo pranë Agropikave dhe zyrave të ekstensionit bujqësor.

Trendi eksporteve bujqësore shqiptare jehonë në mediet prestigjioze ndërkombëtare

Revista e njohur Eurofruit (Britani e madhe - UK) ka publikuar së fundi një artikull sensibilizues të shkruar nga Pëllumb Qosej, mbi rritjen e eksporteve bujqësore shqiptare veçanërisht fruta-perimeve, në tregjet me vlerë të shtuar të BE-së. Ky shkrim pason dy publikime të tjera të ekspertit Qosej, për mollët dhe mandarinat made in Albania, që kanë zënë një vend të rëndësishëm në faqet e prestigjiozes britanike "Eurofruit".

Eksportet e bujqësisë shqiptare në tregjet rajonale dhe europiane njohin vetëm rritje

Frutat dhe perimet shqiptare një mundësi e madhe investimi falë klimës së favorshme, afërsisë me tregjet evropiane dhe punës me kosto të ulët

Eksportet e bujqësisë shqiptare në Bashkimin Evropian arritën një rekord prej 473 milionë euro në vitin 2022, sipas MBU-se, Kjo paraqet një rritje prej 15.6 për qind në vëllim dhe 18.1 për qind në vlerë krahasuar me vitin 2021.

Rritja u nxit nga investimet në infrastrukturën e eksportit, si kapaciteti i ruajtjes dhe ruajtjes së ftohtë. Frutat dhe perimet përbëjnë 20 për qind të prodhimit bujqësor të Shqipërisë, por kontribuojnë me 36 për qind të eksporteve të saj dhe kjo pjesë pritë të rritet, sipas një raporti të Bankës Botërore për vitin 2022.

Perimet serrë si domatet, kastravecet, specat, lakra, qepa dhe preshi janë ndër produktet më të eksportuara të vendit.

Gjithashtu, Raporti i Bankës Botërore përmend klimën e favorshme, afërsinë me tregjet evropiane dhe fuqinë punëtore me kosto të ulët si arsye për potencialin e fortë të investimeve të Shqipërisë, së bashku me cilësinë e lartë dhe konkurrencën e ofertës së saj

përparim në tregun e BE-28, thuhet në raport.

Shqipëria është shumë e varur nga sektori i saj bujqësor, i cili përbën 20 për qind të PBB-së, 40 për qind të punësimit dhe 12 për qind të totalit të eksporteve. Raporti identifikon një sërë sfidash



për eksport.

Në veçanti, domatet përfaqësojnë një mundësi të madhe, pasi ato mund të konkurrojnë në cilësi me produktet e vendeve të tjera në tregjet si Evropa Perëndimore. Këto produkte kanë fituar terren në Ballkanin Perëndimor dhe janë pozicionuar mirë për të bërë

me të cilat përballet Shqipëria, duke përfshirë rritjen e kostove dhe infrastrukturën e dobët.

Produkte të tjera të identifikuar nga Banka Botërore si mundësi të reja eksporti dhe dhe për rritje të të ardhurave për fermerët shqiptarë përfshijnë peshkun, arrat, frutat, shalqinjët dhe ullinjët e konservuar.

ULLINJTË DHE VAJI I ULLIRIT NË SHQIPËRI

SHQIPËRIA MUND TË EKSPORTOJË VAJ ULLIRI TË CERTIFIKUAR ORGANIKISHT ME CILËSI TË LARTË. AKTUALISHT KJO PO NDODH TREND NË RRIJTJE

Prodhimi i vajit të ullirit traditë e vjetër në Shqipëri, por në ekonominë e re të tregut ka fituar vëmendje të shtuar si një potencial i rëndësishëm për gjenerimin e të ardhurave dhe sigurimin e punësimit

Nga Pëllumb Qosej
Ekspert i Zhvillimit të NVM-ve
dhe Nxitjes së Eksportit

Ullinjtë dhe vaji i ullirit në Shqipëri

Shqipëria është një vend mesdhetar dhe ku për më shumë se 3000 vjet, ulliri dhe vaji i ullirit kanë qenë një nga produktet ushqimore më të njohura.

Prodhimi i vajit të ullirit është traditë mjaft e vjetër në Shqipëri, por në ekonominë e re të tregut ai ka fituar një vëmendje të shtuar si një potencial i rëndësishëm për gjenerimin e të ardhurave dhe sigurimin e punësimit. Dekadën e fundit, një vizion i ri për sektorin e ullirit po shfaqet në Shqipëri në angazhimin më të madh drejt vlerave cilësore të larta që karakterizojnë vajrat e specialitetit me identitet rajonal.

Pak histori

Në vendin tonë janë mbjellë dhe mbarështuar ullishtat qysh nga koha e Skënderbeut, ajo e mbretërisë së Zogut, në diktaturën komuniste dhe po vazhdojnë të mbillen edhe këto 20 vite të ekonomisë së tregut. Në agrofondin e ullishtarisë shqiptare, deri në vitet 1945 ishin të regjistruara 1.2 milionë rrënjë ullinj, kryesisht me moshë të madhe, të mbjella në toka të shumë produktive. Prodhimi kokërr në vite të njëpasnjëshme arrinte 25 – 40 mijë tonë ose i njëjësuar me 5 – 8 mijë tonë vaj. Në fund të viteve 1990, ullishtaria zinte mbi 45 200 hektarë tokë me një inventar fizik rreth 6 milionë rrënjë.

Ullinjtë janë ndër kulturat më të rëndësishme të pemëve frutore që rriten në Shqipëri

Gjithësej numërohen pothuajse 12 milion pemë ulliri, me më shumë se 28 lloje – mesdhetare tipike. Me përjashtim të varietetit Frantio të futur nga Italia, tetë varietetet e tjera të rritura më shpesh janë varietetet vendase shqiptare: “Kalinjot”, “Krypi Beratit”, “Bardhi i Tiranës”, “Krypsi i Elbasanit”, “Mixan” dhe “Himara”, të cilat zënë dhe 85% të prodhimit në vend dhe janë të një cilësie shumë të lartë. Dy varietetet kryesore që udhëheqin janë “Kalinjot”, i cili mbulon rreth 40% të plantacioneve totale për përdorimin e vajit dhe tryezës dhe “Kokërrmadhi i Beratit”,

që përfaqësojnë afërsisht 21% të ullinjve të tryezës. Prodhimi i vajit të ullirit po rritet me shpejtësi në Shqipëri, veçanërisht përgjatë bregdetit. Metoda e kultivimit është kryesisht e gjerë dhe shpesh pemët janë pjesë e mjedisit natyror. Pjesa më e madhe e prodhimit plotëson standardet organike.

Zonat kryesore të prodhimit të ullinjve për vajin e ullirit janë Berati, Fieri, Vlora dhe zona midis Elbasanit dhe Tiranës. Në këto zona, 90% deri 95% e kultivarëve janë për prodhimin e vajit të ullirit.

Ndërveprimi i varieteteve shqiptare me mjedisin lokal (toka, klima, lartësia) dhe praktikat kulturore rezultojnë në karakteristikat e veçanta dhe shijet dalluese për vajrat e prodhuar në rajone të ndryshme të të gjithë Shqipërisë. Metoda e kultivimit është kryesisht ekstensive dhe pemët shpesh janë pjesë e mjedisit natyror.

Shumica e prodhimit mbledhet me standardet organike por nuk është certifikuar plotësisht si i tillë. Cilësia e lëndëve të para është e mirë. Aciditeti i vajit është më pak se 3%.

VAJI I ULLIRIT, PRODHIMI SHQIPTAR

SHIFRA PËRMBLEDHËSE

Numri i pemëve të mbjella në prodhim arrin rreth 8.2 milionë (2019)

Shqipëria është vend mesdhetar i përzgjedhur dhe i privilegjuar nga natyra për kultivimin e bimës së ullirit.

- Ushqehen mbi 118 mijë familje fermere,
- Sigurohen mbi 3.5 litra vaj/banor

- Konsumi vjetor 10 kilogramë ullinj tavoline për frymë

Duke llogaritur importet, konsumi i vajit të ullirit është rreth 5 litra/banor, kjo sasi është e ulët në krahasim me vendet e tjera prodhuese të vajit të ullirit si Italia, 16 litra/banor, Greqia 21 litra/banor. Por shqiptarët renditen si konsumatorët më të mëdhenj të ullirit të tavolinës. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit, organizata që përmbledh të gjitha vendet prodhuese dhe konsumuese të ullirit në botë ka publikuar shifrat më të fundit. Sipas këtij burimi, Shqipëria klasifikohet në vend të parë me

konsumin vjetor prej 10 kilogramë ullinj tavoline për frymë me konsum vjetor gjithësej 29 mijë ton në rang vendi.

- Ekonomia kombëtare përfiton mbi 25-30 milionë euro të ardhura në vit.

- Prodhimi kokërr në vitet e fundit arrin 100 000 – 115,000 tonë dhe njëjësuar në vaj ulliri 10 – 13 000 tonë vaj ulliri.

- Total i rrënjëve të ullirit në prodhim 8.2 00.000 (2019)

- Ullinjtë, rendimenti kg/rrënjë 15 (2016)

- Gjithësej rreth 480 linja dhe fabrika përpunimi nga të cilat 160 fabrika të reja të markës “Pieralisi”, “Alfa Laval”, etj.

Shqipëria klasifikohet në vend të parë me konsumin vjetor prej 10 kilogramë ullinj tavoline për frymë me konsum vjetor gjithësej 29 mijë ton në rang vendi. Spanja, e cila është ndër furnizueset kryesore të Europës, konsumon 3,5 kg/frymë. Italia në konsumojnë 2 kilogramë ullinj tavoline në vit ndërsa Greqët edhe më pak, rreth 1,3 kilogramë në vit për frymë.

Vaji i ullirit “Made in Albania”

Eksporti dhe vendet ku eksportojmë

Prodhimi i vajit të ullirit në Shqipëri ka njohur një rritje të ndjeshme nga viti në vit duke ndikuar edhe në rritjen e eksporteve. Rritja e prodhimit të vajit të ullirit ka ndikuar pozitivisht edhe në eksportet e këtij produkti.

Shqipëria mund të eksportojë vaj ulliri të certifikuar organikisht me cilësi të lartë. Aktualisht kjo po ndodh, pavarësisht se në një shkallë të vogël.

Prodhimi, certifikimi dhe eksporti i vajit të ullirit organik filloi në vitin 2003, si pjesë e programit SIPPO (Programi Zviceran i Nxitjes së Importit) që mbështeti kompaninë “Shkalla”, me një certifikatë të lëshuar nga IMO (Agjencia Zvicerane e Inspektimit), të hyjë e para me eksporte në tregun zviceran dhe më vonë kjo u bë pika kryesore e referimit për vajin e ullirit organik shqiptar. “Shkalla” që prodhuesi i parë që fitoi çmimin ndërkombëtar për prodhimin e vajit organik të ullirit “Bio!” në 2005. Qysh atëherë, “Shkalla” fiton çdo vit çmime për cilësinë e lartë, bashkë me disa kompani

të tjera të sektorit të vajit të ullirit, si Musai Sh.p.k., Borshi, Subashi, etj dhe sot eksporton vaj ulliri organik ekstra të virgjër në Zvicër. Prodhimi i vajit të ullirit në Shqipëri ka njohur një rritje të ndjeshme nga viti në vit, duke ndikuar në rritjen e eksporteve. Eksportet shqiptare të vajit të ullirit janë shumë inkurajuese pasi kjo industri po maturohet dhe po arrin të gjitha standartet dhe atributet e kërkuara për cilësinë e vajit të ullirit. Gjatë vitit 2019 Shqipëria eksportoi 174 tonë vaj ulliri me një vlerë prej 35 milionë €. Destinacioni i eksportit të vajit të ullirit: Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kina, Kenia, SHBA etj. dhe importi nga Italia dhe Greqia.

- Eksporti i vajit të ullirit nga industria 174 (tonë) 2019

- Eksport i vajit të ullirit të virgjër nga industria 6 – 9 (tonë)

- Vendet ku eksportojmë Maqedonia, Kosova, Kenia, Britania, Shtetet e Bashkuara, Arabia Saudite, Zvicra, Belgjika, Hongkongu

Perspektiva e ullinjve dhe vajit të ullirit në Shqipëri

Prodhimi i ullinjve është rritur bazuar në kushtet e furnizimit (klima, toka dhe tradita), por gjithashtu është stimuluar nga subvencionet qeveritare.

Vitet e fundit ulliri dhe vaji i ullirit është bërë një nga përparësitë e politikave të qeverisë shqiptare, së pari dhënë për krijimin e një baze relativisht moderne të përpunimit dhe për zgjerimin e prodhimit baza (kultivimi i ri).

Për këtë qëllim, shumica e subvencioneve të dhëna në sektorin e bujqësisë i drejtohen kultivimit të ullirit dhe prodhimit të vajit të ullirit.

Mbjellja e pemëve të reja është rritur jashtëzakonisht shumë si rezultat i programeve mbështetëse të qeverisë dhe iniciativave private. Mbjelljet e reja janë krijuar me praktika moderne dhe menaxhim të mirë. Industria e përpunimit të naftës gjithashtu ka përjetuar një rritje të konsiderueshme.

Disa nga kufizimet për integrimin shqiptar në zinxhirin e vlerës globale të vajit të ullirit

Vaji i ullirit aktualisht është një treg eksporti 7 – 8 miliardë dollarë globalisht që po rritet me një mesatare prej 8.6% në

vit. Megjithëse Shqipëria është liderja e prodhimit në Ballkanin Perëndimor, prodhimi i saj aktualisht qendron në 0.6% të prodhimit të ullirit të BE-28 (udhëheqësi i tregut) dhe nuk është në gjendje të përmbushë kërkesën e brendshme. Sipas një analize të vitit 2012, të sektorit të ullirit të Shqipërisë nga Komisioni Evropian (Analiza e KE), 1 për shkak të fragmentimit ekstrem të pemishteve të saj të ullirit (madhësia mesatare e pemishteve prej 0.2-0.4 hektarë, krahasuar me një madhësi mesatare prej 1.6 hektarësh në Greqi), Shqipëria nuk mund të prodhojë në vëllime të mjaftueshme për të qenë një lojtar i rëndësishëm në tregun e BE-28.

Subvencionet evropiane për vajin e ullirit.

Politika e Përbashkët Bujqësore e BE-së subvencionon fermerët evropianë me 2.3 miliardë US\$ në vit, një vlerë 2 herë më e lartë sesa volumi tregtar botëror prej 1.1 miliardë US\$ (duke përjashtuar tregtinë mes vendeve të BE-së. Rrjedhimisht në supermarketet botërore, 95% e vajrave të ullirit janë evropiane, ndërkohë që prodhuesit e tjerë afrikanë e aziatikë rreth Mesdheut (Maroku, Tunizia, Libani, Siria dhe Turqia) e kanë shumë të vështirë të arrijnë konsumatorin final. Subvencioni evropian është i barazvlefshëm me 1\$ për çdo litër vaj të prodhuar në BE.

Në fokus duhet të jetë dhe është zgjerimi në tregun e vajit të ullirit organik të nivelit të lartë, i cili favorizon cilësinë mbi sasinë apo volumet.

Shqipëria ka potencial për kultivimin e mbi 60 specieve të perimeve më një trend në rritje për disa lloje të perimeve dhe frutave në vitet e fundit.

Aktualisht, qeveria e Shqipërisë synon të shndërrojë “Made in Albania” në një markë të certifikuar dhe të besueshme në tregun ndërkombëtar. Qëllimi është të zhvillojmë produkte të përpunuara konkurruese për të përmbushur kërkesën dhe për të rritur peshën e saj në tregtinë ndërkombëtare. Produktet bujqësore shqiptare gëzojnë një kërkesë të fortë në vende të tilla si Italia, Franca, Belgjika, Zvicra, Evropa Lindore dhe SHBA.

Jo vetëm rritja e sipërfaqeve të mbjella dhe të sasisë së ullinjve të prodhuar por nga ana tjetër rritja e industrisë

prodhuese dhe përmirësimi i teknologjisë së ekstraktimit janë disa nga faktorët kryesorë që do të sjellin kualifikimin e Shqipërisë në eksportet botërore të vajit të ullirit që dominohen nga Spanja, Italia dhe Greqia që së bashku kontribuojnë me 78% të prodhimit botëror dhe 98% të atij evropian.

Produktet kryesore që për Shqipërinë konkurrojnë fuqishëm sot në tregjet e huaja, përfshijnë fruta dhe perime të freskëta dhe të përpunuara, bimë medicinale dhe aromatikë, vaj ulliri dhe mjaltë.

Kushte tarifore kombëtare në Shqipëri për vajin e ullirit

Marrëveshjet tregtare preferenciale të Shqipërisë

Shqipëria ka nënshkruar marrëveshjen me OBT-në në vitin 2000. Në bazë të angazhimeve që janë marrë në këtë marrëveshje, nga Shqipëria nuk zbatohet tarifa për eksportin e vajit të ullirit ndërsa detyrimi i importit është 10% vaj ulliri dhe për të marrë këtë angazhim tarifa nuk rritet mbi këtë nivel.

Kjo tarifë, e njohur si tarifa MFN, do të thotë që Shqipëria zbaton tarifën e këtij niveli për vajin e ullirit të importuar nga të gjitha vendet anëtare të OBT-së, të cilat janë praktikisht pothuajse të gjitha vendet e botës. Nga ana tjetër, nëse Shqipëria dëshiron që disa vende të ofrojnë tarifa preferenciale (nën 10%), atëherë ajo lidh marrëveshje preferenciale tregtare me vende të ndryshme.

Eksportuesit shqiptarë (përfshirë edhe ata të vajit të ullirit) përfitojnë nga një numër i konsiderueshëm i marrëveshjeve tregtare që përfshijnë regjime tregtare preferenciale. Të tilla regjime preferenciale mund të jenë dypalëshe ose shumëpalëshe. Regjime dypalëshe ekzistojnë me BE, CEFTA, EFTA dhe Turqinë. Një regjim unilateral njihet si Sistemi i Përgjithshëm i Preferencave (Generalised System of Preferences (GSP). Një regjim i tillë i jep trajtim preferencial produkteve nga Shqipëria por jo anasjelltas. Bazuar në marrëveshjen asimetrike si dhe MSA që janë në fuqi, Shqipëria mund të eksportojë në tregjet e BE-së vaj ulliri pa taksë, si dhe në SHBA në kuadër të Sistemit të Përgjithshëm të Preferencave (Generalised System of Preferences (GSP).

Krifca me prodhuesit e bukës: Mbrojmë prodhimin tradicional, kontribut në punësim

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca zhvilloi një takim me përfaqësues të Shoqatës së Prodhimit të Bukës, Brumërave dhe Pastiçerive, në ambientet e MBZHR-së, ku diskutoi mbi ecurinë e këtij sektori, nevojat që ata kanë dhe vizionin për të mbështetur këtë industri.

Krifca theksoi se, industria e prodhimit të bukës në vend

fakt atë që po bëjmë edhe me produktet e tjera që po certifikojmë, për sa i takon recetave autentike tradicionale, apo të certifikuara dhe regjistruara sipas emërimit të origjinës”, u shpreh ministria.

Krifca shprehu mbështetjen për prodhuesit e kësaj industrie, që për recetat që ata prodhojnë dhe kanë një traditë shumëvjeçare, do t'i japë

imin e një “Panairi të bukës”.

Ajo theksoi se nevoja e konsumatorëve tanë është që dëgjojnë dhe njohin se në këtë sektor ka edhe inovacion, traditë, por edhe diversitet prodhimi.

Gëzim Peshkopia, kryetari i Shoqatës së Brumërave dhe Pastiçerive, në fjalën e tij bëri një përshkrim të shkurtër rreth shoqatës e cila është krijuar në 1998.



është një nga sektorët më të rëndësishëm jo vetëm për sigurinë ushqimore, por edhe për punësimin.

Ministria vuri në dukje se, prodhuesit e bukës në Shqipëri janë të mirorganizuar në një shoqatë të tyre.

“Bizneset e këtij sektori prodhojnë 100 % bukë artizanale me receta tradicionale që janë mjaft të pëlqyera nga konsumatorët dhe kjo industri jep një kontribut të rëndësishëm në punësimin e të rinjve dhe grave”, tha Krifca.

“Këtë produkt që e prodhojmë me shumë pasion dhe dashuri, duhet t'i japim një vlerë edhe në aspektin e promovimit dhe të bëjmë në

vlerën e caktuar asaj recete duke e mbrojtur, certifikuar dhe promovuar këtë recetë ndërkombëtarisht.

“Diskutua gjerësisht mbi ecurinë e punës në sipërmarrjet e tyre, bashkëpunimin me ministrinë në rolin e politikëbërës të sektorit, por dhe institucionet e varësisë që sigurojnë garantimin e sigurisë ushqimore dhe cilësisë së produkteve kaq të rëndësishme për tryezat e familjeve tona”, tha ministria.

Krifca u shpreh e hapur për të bashkëpunuar me sipërmarrësit e këtij sektori dhe hodhi idenë për organizimin e një forumi dedikuar kësaj industrie, për të diskutuar mbi prodhimin e bukës, si dhe ndoshta edhe për organiz-

“Sipërmarrësit e këtij sektori janë të shtrirë në të gjithë Shqipërinë dhe ajo përfaqësohet nga prodhuesit më në zë të pastiçerisë, bukës dhe brumërave”, tha ai.

“Shoqata ka kryer studime të mirëfillta për prodhimin e bukës sipas zonave, ndërsa është shkruar në një revistë të madhe në Gjermani për bukën e prodhuar në Shqipëri, ku spikati interes i shtuar për bukën me qiqra të zonës së Korçës, por edhe të zonave të tjera të Shqipërisë”, theksoi Peshkopia, teksa vlerësoi tryezën e diskutimit me ministrin Krifca, për një hov të ri në mbarëvajtjen e punës së kësaj industrie.

Veliaj dhe Krifca në tregun e ri agroushqimor në Farkë: Çmime më të lira

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj dhe ministria e Bujqësisë, Frida Krifca prezantuan tregun e ri agroushqimor në Farkë, AgroPark Tiranë, i ndërtuar posaçërisht për fermerët, të cilët mund të shesin produktet e tyre me zero taksa, ndërsa konsumatorët do t'i blejnë më lirë prodhimet bio, të kontrolluara dhe të certifikuara sipas standardeve europiane.

Ministria Krifca tha në takim se “ne jemi mësuar të flasim nëpërmjet punës dhe veprave të kryera”.

“Dua të falënderoj ekipin e Ministrisë së Bujqësisë, Kryetarin dhe të gjithë stafin që iu bashkua këtij vizioni të qeverisë shqiptare, por edhe të Bashkisë së Tiranës për të krijuar një tjetër pol tregtimi dhe zgjerimi të hapësirës së aksesit të fermerëve në tregje.

Në fakt ky është një koncept deri diku risi në Shqipëri,

në konceptin e agregatorit që agregon një mori interesash, veprimtarie tregtare në mënyrë që ndërveprimi të jetë shumë më i thjeshtë, midis fermerëve, tregtuesve dhe konsumatorit. Ne këtë zinxhir veprimi, ferm-



er, konsumator, tregtar kemi ndërmend ta bëjmë bashkë, sepse bashkëpunimi na mundëson të arrijmë rezultate që veç e

veç nuk kemi mundësinë kurrë t'i arrijmë”, u shpreh Krifca.

“Nëpërmjet këtij bashkëveprimi do të rritet fitimi për fermerët dhe kursimi për konsumatorët. Do të mund të përmirësojmë sigurinë ushq-

more duke minimizuar risqet. Bëhen bashkë agropërpunues,

(Vijon në faqen 5)

MBZHR informon fermerët për aplikimin në Skemën Kombëtare

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka nisur fushatën e takimeve për informimin e fermerëve në të gjitha qarqet e vendit, mbi aplikimin dhe masat e financimit që ofron Skema Kombëtare e mbështetje në Bujqësi 2023.

Grupet e ekspertëve të MBZHR dhe AZHBR, po vijojnë takimet intensive, për të informuar të interesuarit në Berat, Fier dhe Vlorë, Elbasan, Korçë, në lidhje me aplikimet online dhe ato me dosje fizike.

Qëllimi është të ndihmojmë fermerët për të shpjeguar hollësisht procedurat që duhet të ndiqen në aplikime

Përfitues për masat mbështetëse mund të jenë fermerë individual, grup fermerësh, persona fizik, juridik, Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor dhe Grupet Vendore të Veprimit.

Për masat direkte, aplikimi bëhet online, me zero dokumente, përmes portalit e-Albania:

Masat direkte janë: Mbështetje

për tufën bazë të matrikulluar (gjedhë); Mbështetje për tufën bazë të matrikulluar (dele, dhi); Bletaria; Fara, fidanë dhe inpute të tjera; Ferment organike; Certi-



fikimi Global Gap; Rinovimi i infrastrukturës së anijeve të peshkimit; Mbështetje për ndërtimin e tregjeve bujqësore; Mbështetje me naftë për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi.

Aplikimet fillojnë nga data

20 mars deri më 11 prill 2023.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i bën apel fermerëve dhe të gjithë të interesuarve që duan të përfi-

tojnë nga Skema Kombëtare e Mbështetjes, se në çdo moment mund të kërkojnë asistencë në numrin pa pagesë 0800 83 83, pranë Agropikave ose nga Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor.

Ekonomia e Shqipërisë dominohet nga sektori agro-ushqimor dhe turizmi

Një analizë për kontributin e sektorëve në ekonominë e vendeve në Ballkanin Perëndimor nga Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare tregon se, ekonomia e Shqipërisë dominohet nga sektori agro-ushqimor dhe turizmi. Agro-industria, Shqipëria me peshën më të lartë në PBB

Studimi i Institutit të Vjenës referoi se sektori i agro-

industrisë ka peshën më të lartë në PBB. Të dhënat tregojnë se në Shqipëri, ky sektor zë 25% të PBB-së, ndërsa në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, 10-15%.

Studimi tregon se të gjitha vendet në Ballkan kanë avantazh krahasues në sektorin e agro-industrisë, falë politikave mbështetëse, ku dominon Shqipëria.

Nga ana tjetër, Marrëveshja e Gjellbër Europiane, kryesisht në aspektin e prodhimit ekologjik dhe të qëndrueshëm të ushqimit po nxit segmente të shkencës dhe teknologjisë, që lidhen direkt me industrinë ushqimore në disa vende të rajonit. Institucioni që ka reputacion të lartë edhe në BE është Instituti BioSense i Serbisë.

Fermerët rrisin prodhimin e luleshtrydhes për në tregjet europiane

Fermerët në Fier kanë shtuar sipërfaqet e tokave të mbjella me luleshtrydhe ku mbi 80% të këtij prodhimi e eksportojnë në

bujqësinë, nga e cila kanë përfitur pothuajse të gjithë fermerët e zonës, por edhe subvencionimi për plasmasin

gun me prodhime cilësore dhe të bollshme.

Marsi shënon edhe nisjen e sezonit të vjeljes së luleshtrydhes dhe fermerët në qarkun e Fierit janë në kulmin e punës. Prodhimi është i mbarë dhe cilësor ndaj tregun e kanë të sigurtë.

Kultivimi i luleshtrydhes është kthyer në biznes fitimprurës për fermerët e kësaj zone. Në Frakull luleshtrydhja tregtohet me shumicë 210 deri në 240 lek për kg, por vetëm 15% e prodhimit mbetet për tregun vendas.

Me një prodhim prej 75 mijë kuintalësh në sezon, luleshtrydhja e Frakullës eksportohet në Itali, Rumani, Poloni e Çeki.

Vetëm në Frakull të Fierit janë mbi 280 fermerë që kultivojnë luleshtrydhen me një sipërfaqe totale prej 170 ha. Pjesa më e madhe e tyre janë mbështetur nga Ministria e Bujqësisë me subvencione si për naftën ashtu dhe për ndërtimin e serrave.



tregjet europiane.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural përmes politikave dhe mekanizmave të financimit po i mbështet fermerët e këtij sektori që kultivojnë “frutin e kuq” kryesisht në serra, sipas teknologjive më të mira. Skema e naftës falas për

në serra janë lehtësi që u janë kthyer në më shumë të ardhura familjeve fermere.

Trendi dhe modeli i biznesit të luleshtrydhes është kthyer në pasion edhe për shumë të rinj të zonës, që po angazhohen në bujqësi duke aplikuar dhe projekte novatore për të konkurruar sa më mirë në tre-

Firmoset strategjia 5-vjeçare me BB, 900 mln USD investime në bujqësi, ura dhe zhvillim ekonomik

Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Botërore ka aprovuar strategjinë 5-vjeçare të partneritetit me Shqipërinë (2023-2027).

Kjo strategji synon të ndihmojë vendin të rimëkëmbet shpejt dhe të transformohet në një ekonomi më të fuqishme, më gjithëpërfshirëse, me aftësi ripërtëritëse dhe më të gjelbër.

Në një njoftim për shtyp, zyra e BB në Tiranë, bën të ditur se, strategjia do të përqendrohet në tri sfida kyçe: më shumë dhe vende më të mira pune, përdorim më i mirë i kapitalit njerëzor, dhe rritje e aftësisë përballuese dhe ripërtëritëse ndaj fatkeqësive natyrore dhe goditjeve të llojeve të tjera.

Këto drejtime kryesore do të ndërthuren edhe me iniciativa për zgjerimin e digjitalizimit dhe përfshirjes.

Strategjia e Partneritetit është në përputhje me përparësitë strategjike të qeverisë dhe mbështetet nga një portofol financiar prej 900 milionë dollarësh.

Bordi gjithashtu ka aprovuar 4 projekte të reja për Shqipërinë: Projekti i rindërtimit të urave rezistente (100 milionë \$) që synon rehabilitimin e urave në rrezik dhe përmirësimin e sistemeve të tyre të mirëmbajtjes;

Projekti i Bujqësisë konkurruese dhe të qëndrueshme ndaj klimës (70 milionë \$) që do të përqendrohet

në nxitjen e inovacionit në bujqësi, në zgjerimin e ujitjes inteligjente dhe rritjen e aksesit të produkteve bujqësore në tregjet vendase dhe ato të BE-së;

Projekti i Qasjes Universale në Shërbime Publike me Standard të Lartë (GovTech) (65 milionë \$) që do të ndihmojë digjitalizimin e shërbimeve publike dhe zgjerimin e aftësive digjitale për fëmijët në shkolla;

Projekti i Financimit të Politikave të Zhvillimit (120 milionë \$) që do të ndihmojë në forcimin e aftësisë ripërtëritëse të ekonomisë dhe qëndrueshmërinë mjedisore të modelit të rritjes së Shqipërisë.

Skema kombëtare, subvencion deri 150 mijë lekë subjekteve në bletari

Në vendin tonë prodhohen mbi 5 mijë tonë mjaltë në vit.

Qeveria po zgjeron mbështetjen me fonde nga Skema Kombëtare për bletarinë, teksa mbarëshkrimi i bletëve po

dhe Zhvillimit Rural bëri të ditur se Skema Kombëtare e Mbështetjes në Bujqësi 2023 financon drejtpërdrejtë bletarët me 1000 lekë për zgjua për fermat që kanë jo më pak se 50

si në Masën 2 për bletari, që ishin 2794 fermerë dhe 299 905 koshere të shpërndara nëpër të gjithë vendin.

Një zhvillim tjetër pozitiv për sektorin e bletarisë në vend është edhe miratimi i ligjit të ri për Bletarinë që i hap rrugë mbrojtjes, regjistrimit, regjistrimit dhe certifikimit të tij me potencial për eksport në rritje. Kjo është një mundësi e madhe për bletërritësit shqiptarë, që do të rrisin prodhimin vendas dhe të ardhurat në ekonominë e tyre familjare.

Fondet për mbështetjen e bletarisë që prej vitit 2014 janë rritur me 749 %.

Shqipëria konsiderohet si vendi i përshtatshëm për të ushtruar një veprimtari të tillë, pasi favorizohet nga kushtet klimatike si dhe flora e pasur.



shndërrohet në tendencë në të gjithë vendin, si një biznes me përfitime të konsiderueshme që synon rritjen e eksporteve.

Ministria e Bujqësisë

koshere dhe deri në 150 mijë lekë për subjekt.

Vitin e kaluar (2022) Skema Kombëtare mbështeti me 299 905 000 lekë të gjithë aplikue-

Skemat e mbështetjes në bujqësi deri në 360 mijë lekë për fermat me të imta

Falë skemës kombëtare të mbështetjes në bujqësi, fermerët mund të përfitojnë deri në 360 mijë lekë mbështetje financiare.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca informoi se, aplikimet përmes e-Albania janë të hapura prej datës 20 mars deri në 11 prill.

“Masa 2 është për tufën bazë të matrikulluar, për fermat me jo më pak se 100 krerë dele e dhi në vlerë deri në 1200 lekë/krerë, por jo më shumë se 360 mijë lekë për subjekt”, tha ajo.

Referuar statistikave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në vitin 2022, u rrit me 20% numri i fermave blegtorale me mbi 200 krerë të imta, krahasuar me vitin 2021.

Në vitin 2022 u shënuan 3 030 ferma blegtorale me mbi 200 krerë të imta, kundrejt 2 528 fermave që ishin në vitin 2021.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022 u rrit me 68% numri i fermave blegtorale të licencuara. 47 ferma të reja blegtorale u regjis-

truan nga AKVMB në 2022, ndaj 28 fermave të reja që u licencuan në vitin 2021.

Në mbështetje të këtij sektori, është shtuar nga viti në vit dhe fondi nga buxheti i shtetit për subvencionimin e blegtorëve.



Agjencia e startup-eve, Bilali: Shkurtojmë kohën e disbursimit të granteve

Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Edona Bilali tha se, një tjetër ndryshim në ligjin për mbështetjen dhe zhvillim e startup-eve është edhe krijimi i Agjencisë së Startup-eve, apo e njohur ndryshe si Start-up Albania.

Bilali në prononcim për mediet, pas mbledhjes së qeverisë tha se, “kjo vjen si një iniciativë, e cila duke qenë se vjet ne miratua një fond 2.5 milionë euro, i cili u shpërnda dhe kishim rezultate fantastike për ekosistemin ku mbështetëm 29 startup-e, ku 38 % e përfituesve ishin të kthyer nga emigrimi dhe 34 % ishin gra dhe vajza”.

Ministria theksoi se, “ne



synojmë që këtë vit, përmes Agjencisë edhe të rrisim eficiencën e shpërndarjes së

këtyre fondeve, por edhe të shkurtojmë kohën e disbursimit të granteve”.

Veliaj dhe Krifca në tregun e ri agroushqimor në Farkë: Çmime më të lira

(Vijon nga faqja 4)

grumbullues, shitësve të in-puteve bujqësore, të institucioneve shtetërore, ekstensionistëve, agronomëve të shtetit, të cilët do të jenë këtu së bashku me ekspertë të fushës. Institucioneve financiare për t'i dhënë më shumë akses në financë, bankat, institucionet e mikrokredisë dhe projekte të ndryshme zhvillimore të cilat do të jenë gjithashtu këtu prezent”, tha ministria Krifca.

Në fjalën e tij, kryebashkiaku Veliaj u shpreh se ky investim u vjen në ndihmë fermerëve dhe zonave rurale.

“Ky ishte premtimi i fundit i pambajtur dhe më vjen mirë që pranvera na gjen me një projekt, ndoshta më i miri dhe më i arrituri në rajonin tonë. Ky vend ka edhe një vendosje gjeografike fantastike. Jemi buzë autostradës, Unazës së Madhe të Tiranës, mes Lundrës dhe Farkës, dhe për të gjithë ata që kundërshtojnë Unazën, që protestojnë tek Astiri, sot kërkojnë vota, por duhet t'i thonë publikut se çfarë ndodhi me vitet që humbëm kohë kot. Po bëjmë edhe një park të ri në Liqenin e Farkës dhe ditët më

të mira për fshatin sapo kanë filluar”, u shpreh Veliaj.

Kryebashkiaku sqaroi se tregu i ri do u kursejë tregtarëve 70% të kostove, që më parë paguanin te privati, e po ashtu do u ofrojë qytetarëve produkte bio më të lira.

“Në tregun privat ti paguaje pa e ditur se çfarë do të shisje, pa e ditur se sa është bursa në treg, sepse kishte një çmim fik. Në këtë treg kemi pagesa deri në 70% më të ulëta, jo për të nxjerrë fitim, por të sigurohemi që këtu mbahet pastër, që ka roje, ndriçim, higjienë, dhe ka një lloj rendi vetëm për të mbuluar kostot, duke i kursyer secilit 70% të pagesave që shkonin për fitimin e privatit. T'i japësh fermerit më shumë para nga produkti i tij, t'i kursesh tregtarit më shumë nga këto vara-vingot e harxhim naftë, duke ardhur te rruga dytësore e autostradës Tiranë-Durrës, dhe ta përthesh të gjithë këtë kursim në çmime më të ulëta për produktet bujqësore të prodhuara në Shqipëri dhe në Tiranë, me më pak kosto, është një sukses i jashtëzakonshëm”, nënvizoi ai.

Veliaj njoftoi edhe një sistem transparence për produktet që do të shiten në këtë treg. “Siç ek-

iston bursa jashtë, për shumë prej produkteve duhet të kemi edhe një minibusë këtu. Do të kemi një tabelë të çmimeve, ku njerëzit dinë sipas kërkesës dhe ofertës, ku rrahin çmimet. Ky sistem transparence sigurisht që e bën më kompetitiv tregun, informon njerëzit jo vetëm për çmimin, por edhe për origjinën nga ka ardhur. Tradita e mirë që kemi filluar, duke marketuar disa produkte, siç është domatja e vonë e Shëngjergjit, gjeli i Baldushkut apo ulliri i Ndroqit, është diçka fantastike. E vlerësoj vërtet si gjest patriotik solidaritetin që kemi për të qarkulluar paratë brenda ekonomisë së qytetit tonë”, deklaroi ai.

Ndërkaq, Veliaj tha se e gjithë Farka është transformuar me Parkun e Liqenit e me të tjera investime, ku është punuar një-lloj, si në qendër edhe në periferi.

“Parku i ri i Farkës do jetë ndoshta konkurruesi më i fortë i Parkut të Liqenit të Tiranës, me një sipërfaqe më të madhe, një investim i bërë që në fillim. Kush e mendonte më parë se në Farkë do të bënim finalitet e Kupës së Republikës së Shqipërisë në basketboll dhe në volejbol”, theksoi Veliaj.

Skema e trajnimit, fermeri nga Cërriku zbaton njohuritë për kultivimin e kivit

Lulëzimi Bullari është një fermer nga qyteti i Cërrikut, i cili ka sipërfaqe të konsiderueshme të mbjella me arra (90 ha), bajame (90 ha) dhe kivi (45 ha).

Lulëzimi i bashkuar Skemës së Trajnimit në Bujqësi dhe në bashkëpunim edhe me projektin e gjerman GIZ për bujqësinë u mundësua të përvetësojë njohuri të vlefshme dhe bashkëkohore, konkretisht mbi arrën dhe kivin, të cilat ka mundur t'i aplikojë në parcelat që ai zotëron.

Falë serisë së trajnimeve ai ka mundur të fitojë aftësi të reja mbi mënyrën e mbledhjes,

pastrimit, tharjes dhe paketimit të arrës.

Aktualisht, fermeri është duke bashkëpunuar me një projekt të

mbrojtjes së kivit, duke ndërtuar një brez pyjor rreth 1.66 km, i cili do të mbrojë pemët e kivit nga dëmtimi i erës.



Skema Kombëtare, 4 hapat e aplikimit me zero dokumente nga fermerët

Aplikimi për Skemat Kombëtare të Mbështetjes për Bujqësinë 2023 janë hapur që prej ditës së djeshme dhe fermerët aplikojnë online në e-Albania me zero dokumente.

tetit, zgjidh shërbimin "Aplikim për Skemën Kombëtare të mbështetjes për fermerët", zgjidh llojin e fermerit, vendndodhjen e fermës, masën si dhe sasinë për të cilën do të aplikojnë.

jashtohet nga aplikimi i gabuar ndërsa në të gjithë vendin janë 20 agropika dhe 35 qendrat e AREB-ve në dispozicion të aplikantëve për Skemën Kombëtare të mbështetjes në Bujqësi që zhvillohet nga data 20 mars deri më 11 prill 2023.

Fondi i parashikuar në Skemën Kombëtare për vitin 2023 është 3,3 miliardë lekë.

Skema Kombëtare financon 9 masa: Masa 1: Tufa bazë e matrikulluar (gjedhë). Masa 2: Bletaria. Masa 3: Mbështetje për tufën bazë të matrikulluar (dele, dhi). Masa 4: Fara, fidanë dhe inpute të tjera. Masa 5: Mbështetje për fermat organike. Masa 6: Certifikimi GlobalGAP. Masa 7: Rinovimi i infrastrukturës së anijeve të peshkimit. Masa 8: Mbështetje për ndërtimin e tregjeve bujqësore. Masa 9: Mbështetje me naftë për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi.



Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural bëri të ditur katër hapat që duhet të ndjekin fermerët për kryerjen e aplikimit.

"Fillimisht regjistrohu në e-Albania, si qytetar, me të dhënat e kartës tuaj të iden-

ni dhe kliko dërigo. Vetëm katër hapa dhe aplikimi u krye me sukses", informoi MBZHR.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është angazhuar maksimalisht në informimin e fermerëve me qëllim që askush të mos për-

BB, investime në pajisje për laboratorët e AKU-së

Banka Botërore (BB) mbetet një partner strategjik për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe qeverinë shqiptare, në rrugën për një bujqësi të qëndrueshme dhe një sistem të qëndrueshëm ushqimor.

Grupi i Bankës Botërore ka aprovuar një strategji partneriteti 5-vjeçare me Shqipërinë (2023-2027) dhe njëri nga katër projektet e reja që do ta ndihmojë vendin të transformohet në një ekonomi më të

fortë, gjithëpërfshirëse i kush-tohet Bujqësisë.

Projekti i Bujqësisë Konkurruese dhe me Aftësi Përballuese ndaj Klimës me vlerë 70 milionë USD do të përqendrohet në nxitjen e inovacionit në bujqësi, në zgjerimin e ujitjes inteligjente dhe rritjen e aksesit të produkteve bujqësore në tregjet vendase dhe ato të BE-së.

Siguria ushqimore do të mbështetet me investime në pajisje të laboratorëve të AKU-

së, pika të inspektimit kufitar sipas standardeve europiane dhe dhoma freskie e frigoriferike për ruajtjen e produkteve të bllokua/sekustruara.

Banka Botërore e cilëson bujqësinë një sektor kyç në ekonominë shqiptare, që kontribuon me 19% në PBB e vendit dhe 36% të punësimit.

Projekt i ri i mbështetur nga Banka Botërore do të ndihmojë sektorin të jetë më produktiv dhe konkurrues.

Nga i paragjykuar në model zhvillimi, arsimit profesional po ndryshon të ardhmen e të rinjve

Nga Pëllumb Qosej

Ekspert i Zhvillimit të NVM-ve dhe Nxitjes së Eksportit

Arsimi profesional po fiton terren në Shqipëri, teksa gjithmonë e më shumë të rinj po zbulojnë avantazhet e një gjimnazi që krahas arsimit të përgjithshëm, të përgatit për tregun e punës me aftësi praktike dhe të dobishme për një zanafillë apo profesion specifik.

Qeveria e Zvicrës po punon prej vitesh për të ndihmuar vendin të reformojë sistemin e tij të arsimit profesional, duke e njohur si një shtyllë për zhvillimin ekonomik. Me mbështetjen e tyre, Shqipëria ka bërë progres të rëndësishëm në rritjen e cilësisë dhe rëndësisë së këtyre programeve. Edhe pse ka akoma shumë rrugë përpara. Arsimit profesional ka potencial për të luajtur një rol të madh në tkurrjen e fenomenit të emigracionit mes të rinjve. Shumë shqiptarë lënë

vendin në kërkim të perspektivave më të mira për punë, shpesh duke cituar mungesën e mundësive brenda vendit. Por me ofrimin e aftësive dhe njohurive praktike, arsimit profesional mund të ndihmojë në krijimin e këtyre mundësive dhe inkurajimin e të rinjve që të qëndrojnë në Shqipëri. Pasioni është një nga arsyet kryesore që të rinjtë zgjedhin shumë prej degëve profesionale si teknologjia e informacionit, turizmi, gatimi, apo rrobaqepësia dhe tekstili. Dhe nëse këto pasione shfrytëzohen për të ndërtuar diçka në Shqipëri, ekonomia dhe të gjithë ne, mundet vetëm të përfitojmë.

Ambasadorja zvicerane thotë se anketa tregoi rezultate interesante. Në anën pozitive pamë se shumica e nxënësve kanë një pikpamje pozitive të arsimit dhe aftësive që ata

marrin. Ata mendojnë se arsimit profesional është një zgjedhje e mire, një mundësi e mirë për të rinjtë që të marrin aftësim dhe të kenë prespektivë për jetën e tyre. Anketa tregoi gjithashtu se arsimit dhe formimi profesional ka një imazh të mirë edhe krahasur me arsimin e përgjithshëm. Anketa tregoi gjithashtu sfida dhe boshllëqe për t'u plotësuar.

Fushat dhe prioritet sipas opinionit të nxënësve janë zgjerimi i fushave të studimit, përmirësimi i infrastrukturës dhe pajisjeve të shkollave, përmirësimi i aftësive të mësuesve veçanërisht aftësive komunikuese, madje promovimi i mëtejshëm i arsimit profesional në vend. Të gjitha këto janë fusha ku duhet punuar dhe ku të gjithë aktorët e përfshirë duhen të veprojë.

Skema Kombëtare në Bujqësi, AZHBR: Aplikohet me një nga katër dokumentet e pronësisë

Fermerët aplikojnë me një nga katër dokumentet e pronësisë në Skemën Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi 2023.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, informon se, dokumenti i pronësisë me të cilin mund të aplikojnë janë: Certifikata e pronësisë (shoqëria me kartelën e pasurisë dhe hartën treguese); AMTP

(aplikanti është përfaqësues i familjes bujqësore); AMTP +Marrëveshje dakordësie (aplikanti është anëtar i familjes bujqësore); Kontratë qiraje ose huapërdorje (në mungesë vlen edhe një marrëveshje dakordësie mes palëve).

AZHBR bën të ditur se, është pranë fermerëve në çdo rast që paraqitet e nevojshme.

Ekipet e specialistëve asistojnë fermerët në 55 pikat (20 Agropika dhe 35 qendra AREB) ku aplikohet për Skemën Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi, ndërkohë që në çdo moment mund të kërkojnë asistencë në numrin pa pagesë 0800 83 83, pranë Agropikave ose në Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor.

Nuk është kurrë e lehtë të drejtosh biznesin tënd, apo të hapësh një të tillë rrishtazi gjithashtu. Shpesh herë, ne e gjejmë veten duke kërkuar ndihmë nga të tjerët, veçanërisht nëse duam ta zgjerojmë atë.

Dhe pavarësisht gjithçkaje, në përgjithësi, është relativisht e vështirë kur bëhet fjalë për gjetjen e një partneri biznesi. Sidomos, nëse jeni duke kërkuar për një partner ndërkombëtar importues në një vend të huaj. Në këtë drejtim, janë disa gjëra për t'u marrë parasysh.

Ku dhe si të gjenden klientët e rinj?

Është një nga pyetjet kryesore për një sipërmarrës e cila bëhet edhe më e mprehtë kur flitet për gjetjen dhe hyrjen në tregje të reja. Gjithsesi nuk ka një formulë apo një klishe në mënyrën se si gjenden klientët e rinj pasi dihet që të gjitha tregjet dhe sektorët janë të ndryshëm.

Cfarë duhet patur parasysh: Besueshmëria

Besueshmëria është një faktor i madh dhe i rëndësishëm kur kërkoni një partner biznesi. Nëse nuk ka referenca ose prova për të mbështetur përvojën tuaj,

Si të gesh partnerë biznesi jashtë vendit për të eksportuar

Nga Pëllumb Qosej, Ekspert i Zhvillimit të NVM-ve dhe Nxitjes së Eksportit

atëherë si mund të besoni në ndërtimin e një partneriteti me këtë person? Të gesh dikë që të besosh me biznesin tënd nuk do të jetë kurrë e lehtë, por ka disa mënyra që mund ta bëjnë atë më pak të vështirë sesa duhet.

Klientët ekzistues

Klientët ekzistues janë një burim premtues për të gjetur klientë të rinj – veçanërisht nëse ata janë të bindur për cilësinë e produkteve dhe besueshmërinë e kompanisë eksportuese. Zakonisht, klientët janë të interesuar në parim për një marrëdhënie të qëndrueshme afatgjatë dhe si rrjedhojë janë të hapur për rritjen e furnizuesve të tyre.

Si hap i parë, ata duhet të pyeten për kompani të tjera të cilat mund të jenë të interesuara për mallrat që do eksportohen. Në disa raste, madje, ata mund ta kenë Klientët të Rinj dhe Blerësit ekzistues për të rekomanduar kompaninë tek të tjerët. Ne vijim dhe në rast të një marrëdhënieje shumë të mirë me klientët ekzistues atij mund t'i kërkohej të prezantohet të klientët e rinj potencialë.

Rrjetet e prodhuesve dhe eksportuesve shqiptarë

Një burim i mirë informacioni për klientët e rinj potencialë janë kompanitë shqiptare që kanë filluar tanimë eksportimin në tregje të caktuara. Pavarësisht se ata nuk mund ta identifikojnë saktësisht klientët e duhur, ata mund të ofrojnë informacion premtues për të kontaktuar dhe gjetur klientë të rinj. Mund të referohesh p.sh: Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë www.prodhues.org; Keshilli I Agrobiznesit Shqiptar (KASH): www.kash.org.al; Shoqata e grumbulluesve, perpunuesve dhe eksportuesve të Shqipërisë (ACPEM): <http://amap.org.al/>

A mund të ndihmojnë agjencitë shtetërore/ qeveritare?

Agjencitë qeveritare mund të jenë shumë të dobishme, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. Ata mund të jenë një burim i pasur idesh dhe kontaktesh brenda dhe jashtë vendit. Një e tillë është Agjencia Shqiptare të Investimeve të Huaja AIDA

që ofron informacione për tregje, kontakte apo partneritete biznesi duke iu siguruar një pasqyrë të partnerëve potencialë të biznesit në vendin tuaj të zgjedhur. Shih: Partenerë biznesi - AIDA <https://www.facebook.com/investinalbania>. Në kuadër të misionit të saj AIDA ndër të tjera mbështet SME vëndase ne gjetjen e tregjeve të reja dhe promovimin prodhimet të tyre jashtë vendit nën markën "Made in Albania".

Për hyrjen në tregje, përfshirë tregtine e jashtme, tregjet konsumatore, cmimet, tendencat dhe të tjera një burim i rëndësishëm në Shqipëri është Agjencia Shqiptare e Statistikave INSTAT: www.instat.gov.al

Organizatrat për mbështetjen e biznesit (OMB)

OMB-të në Shqipëri do të mund të japin informacionin e duhur në lidhje me sektorin tuaj si edhe për tregjet e synuara në Europë. Shembuj të organizatave që mbështesin biznesin në Shqipëri janë Agjencia Ra-

jonale e Zhvillimit (ARZH <https://rdatirana.al/>), Albexport, Biznes Albania, etj

Misionet tregtare dhe të biznesit

Një nga mënyrat më të mira për të gjetur një partner biznesi është duke iu bashkuar një misioni tregtar pasi ai është gjithashtu vendi i përsosur për të takuar dhe për të gjetur kandidatit e përsosur për një partner të mundshëm biznesi. Ju mund merrni pjesë në një mision biznesi apo tregtar organizuar nga Institucione mbështetëse të biznesit si MBU, AIDA, DHTI, etj.

Interneti/ Rrjetet Sociale

Kërkimi në internet dhe Rrjetet sociale janë të dobishme në gjetjen e partnerëve të mundshëm dhe të të japin një përshtypje të parë për klientët potencialë. Këto faqe ju lejojnë të shikoni referencat e partnerëve të mundshëm të biznesit, si dhe CV-të e tyre dhe historinë e punës.

Në këtë drejtim, një burim

i mirë informacioni mund të gjendet në kataloget online të eksportitave që ndihmojnë për të gjetur blerësë rinj. Ata ofrojnë informacione të tilla si web faqe për blerësat dhe kontaktet e tyre. Një shembull i tillë është katalogu online i Panairëve të njohura Nderkombetare si Fruitlogistikës në Berlin (<https://www.virtualmarket.fruitlogistica.de/en/exhibitors>) apo Biofach, Nurenberg, Gjermani (<https://www.biofach.de/en/exhibitors>)

Burime databazash

Ne menyre të permbledhur burime të ndryshme që mund të eksplori për të gjetur partnerin më të mirë për biznesin tuaj ndërkombëtar.

- Kontrolloni (informacionet e vendit) dhe merrni këshilla specifike për gjetjen e klientëve dhe partnerëve të biznesit. P.sh mund të merrni informacion nga agjentët ose kontaktet e kolegëve që operojnë në të njëjtin sektor.

- Shoqatat e Biznesit /tregtare apo shoqatat e bizneseve të huaja që funksionojnë në Shqipëri mund të jenë shumë të dobishme, si në Shqipëri ashtu

SIPËRMARRËSIT E RINJ NË BUJQËSI

Bletari nga Kukësi, shembull mbresëlënës i të rinjve që po lënë emigrim për të investuar në fshat

Bletari Lefter Lushi, 42 vjeç, nga fshati Shkinak, Grykë-Çajë i Kukësit, është një tjetër shembull mbresëlënës i të rinjve që po lënë emigrim për të investuar në fshat.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca publikoi historinë e Lefterit, që u kthye nga emigrimi për t'iu përkushtuar bletarisë në fshatin ku jeton.

Lushi thotë se, bletaria është pasion, dashuri, jetë, teksa tregon se, bletët i mban mend që kur shkante për t'i parë me gjyshin.

“Më vonë ika në emigrim dhe mendoja se s'ia vlen të merresha më me to. Por kur u ktheva dhe kam që në 2011 që merrem vetë me bletët”, thotë Lushi.

“Bletët është pasion, nuk e bëjmë për përfitim. Bleta është jeta. Tre muaj e dimrit këtu punoj dhe kënaqem. Kur punoj

me bletët nuk lodhem, kam adrenalinë”, shprehet ai.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është anga-

aktorëve të përfshirë në këtë sektor, u hartua ligji i ri për bletarinë, i cili u miratua dhe në Kuvendin e Shqipërisë, duke i



zhuar fort për të mbështetur bletarët dhe zhvillimin e sektorit që është mjaft jetik dhe i rëndësishëm për ekonominë dhe bujqësinë.

Me nismën e drejtpërdrejtë të ministres Krifca dhe në bashkëpunim të plotë me Shoqatën e Bletarëve dhe të gjithë

hapur kështu rrugë mbështetjes së bletarëve për regjistrimin, certifikimin dhe daljen në tregje për eksport të tyre.

Ndërkohë që politikat e mbështetjes nga Skema Kombëtare vijnë në këtë vit me objektivin për subvencionimin e të gjithë bletarëve aplikantë.

Të rikthyer nga emigrimi, fermerët romë në Seman marrin certifikatën e tokës

Fermerë të komunitetit rom dhe egjiptian të rikthyer nga emigracioni në fshatin Seman të Fierit janë pajisur me certifikatën e tokës, falë mbështetjes nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe projektit “Riintegrimi socio-ekonomik i të kthyerve”, të financuar nga Bashkimi Evropian.

“Kaluan tridhjetë vjet dhe ne nuk mund të merrnim certifikatat tona të tokës. Falë institucionit bujqësor dhe këtij projekti në bashkëpunim me OJF-në më në fund i kemi certifikatat. Ne nuk kemi të ardhura, kështu që nuk mund të përballonim të aplikonim për to”, shprehet Laureta Xhelali, fermere e rikthyer.

Fshati Seman në Fier ka tokë të bollshme bujqësore dhe një traditë të gjatë në fushën e bujqësisë. Por, për shumë familje romë dhe egjiptiane është e vështirë të vërtetohet pronësia e tokës.

Minetor Kazanxhiu tregon se ka qenë emigrant në Gjermani, por atje e kishte të vështirë të bënte letrat dhe ishte i papunë,

ndaj vendosi të rikthehej me familjen në fshatin e tij.

Ai tregon se marrja e certifikatës për tokën e ka ndihmuar atë të aplikojë dhe përfitojë nga skema e mbështetjes së qeverisë për kultivimin e grurit.

Eduart Koçi, përfaqësues i shoqatës së romëve thotë se, “për aftësimin e fermerëve për kultivimin e grurit me mbështetjen e MBZHR u zbatua edhe një program i posaçëm trajnimi për mbjelljet dhe tani jepen këshilla të vazhdueshme për çdo proces që duhet të kryejnë fermerët”.

Fermerët tregojnë se pajisja me certifikatën e pronësisë së tokës dhe skemat e subvencionimit i kanë nxitur ata të shtojnë sipërfaqet e mbjella.

“Unë më parë mbillja 2 dynmë tokë, falë ekspertëve të bujqësisë dhe shoqatës që na ndihmuan sot kam mbjellë 1 ha tokë”, u shpreh Anila Kazanxhiu, teksa shtoi se, “ne synojmë të bashkohemi si fermerë, të rrisim prodhimin dhe të konkurrojmë në treg”.

Gjithashtu, një mbështetje

e madhe për fermerët ka qenë edhe skema e trajnimit që u ka ofruar bujqve romë dhe egjiptianë këshillimin e duhur për punët në bujqësi, të cilët në vitet në vazhdim do të jenë në gjendje të zbatojnë vetë teknologjinë e kultivimit të grurit.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me projektin e financuar nga BE “Riintegrimi socio-ekonomik i të kthyerve” dhe PNUD që ndërliket me OJF-në lokale romë “Të gjithë së bashku për Integrimin e Romëve”, po kontribuojnë duke ndihmuar të kthyerit nga emigrimi, të kenë të drejta pronësie mbi tokën dhe të sigurojnë punë dhe të ardhura përmes bujqësisë.

Aktualisht, janë 16 familje romë në Seman që janë mbështetur për marrjen e certifikatës së tokës, 18 familje janë mbështetur për kultivimin e grurit, ndërkohë që fermerët gjithashtu trajnohen për praktikatat më të mira në bujqësi.



Fermeri në Boboshticë, implementon në bujqësi dijet e marra në emigrim

Skemat mbështetëse me grante dhe subvencione kanë sjellë rivitalizimin e investimeve në bujqësi dhe agroturizëm.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca ndau historinë e Ilir Myrtollari, 31-vjeçarit nga Boboshtica e Korçës, që është rikthyer në vendlindje dhe po investon në bujqësi, ndërsa shprehu mbështetjen me subvencionet dedikuar emigrantëve, të rinjve dhe grave, që duan të jetojnë e punojnë në fshat.

Ilir Myrtollari, tregon se prej 4 vitesh po punon në tokën e tij, duke implementuar dijet e marra në emigrim, sepse siç

thotë ai, “bujqësia kërkon cilësi dhe standarde”.

“Kam punuar në Greqi për

Unë kryej procesin e kriposjes së djathit kaçkavall në të thatë.

Ky proces zgjat 45 ditë dhe



shumë vite dhe atje jam marrë me bujqësi. Bujqësia ka çdo gjë të mirë dhe të gjitha proceset e punës mua më pëlqejnë.

bëhet çdo 2-3 ditë. Teknika e avancuar na shërben të ofrojmë standard dhe cilësi”, thotë Myrtollari.

Pas 10 vitesh në Itali, emigranti rikthehet dhe investon në vendlindje

Elton Meço nga Libofsha, është një tjetër i ri, i kthyer në vendlindje, pas disa vitesh në emigracion, i cili ka ngritur një

Ai shprehet se, “kam qenë emigrant prej 10 vitesh në Itali dhe kam punuar në serra në Sicili. Menduam që

rieteti përshtatej me klimën dhe shtuam sipërfaqen. Tani kemi 2 hektarë dhe tregu është i kënaqshëm, pasi ky është rrush eksporti”.

Prodhimi vendas i rrushit po dominon gjithnjë e më tepër furnizimin e tregut si me rrush tavoline, ashtu edhe me atë për përpunim.

Zonat kryesore të prodhimit të rrushit gjenden mes kodrave dhe bregdetit të Shqipërisë Qendrore. Fieri, Berati, Elbasani dhe Vlora, janë qarqet me përqindjen më të madhe të prodhimit; këto katër qarqe japin më shumë se gjysmën e prodhimit vendas të rrushit.

Ndërkohë importet kanë rënë në mënyrë domethënëse nga viti në vit.



biznes familjar.

Sot ai ka rreth 2 hektarë serra me rrush tavoline dhe rreth 20 ha tokë të marrë me qira, të cilën e ka mbjellë me të gjitha llojet e drithërave.

me të ardhurat e mbledhura gjatë këtyre viteve të bënim të njëjtën gjë dhe në vendin tonë. E nisëm me një sipërfaqe të vogël prej 4 dynmë, na eci, e pamë që dhe këtu va-

Pagesa direkte deri në 1.5 mln lekë fermerëve për fara/fidanë dhe inpute bujqësore

Skema Kombëtare e Mbështetjes së Bujqësisë 2023 ofron pagesa direkte për fermerët për fara/fidanë dhe inpute bujqësore, me qëllim uljen e kostove të prodhimit.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca informoi se, falë Skemës Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi për këtë masë, fermerët ose grupfermerësh mund të përfitojnë deri 1.5 milionë lekë mbështetje financiare.

“Masa 4 është mbështetje për fara/fidanë dhe inpute të tjera me vlerë deri në 200 000 lekë për ha për sezon dhe jo për më shumë se 2 sezone për kultivimin e perimeve, rrushit në tavolinë për serra dhe/ose luleshtrydhe në tunele plastike për fermerë individualë dhe grupfermerësh me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 ha dhe jo më shumë se 1 500 000 lekë për aplikant”, tha

Krifca.

Ministrja i bën thirrje fermerëve të aplikojnë përmes e-Albania, teksa thirrja është e hapur prej datës 20 mars deri në 11 prill.

Fondi total për subvencionimin e bujqësisë është 3.3

nga ferma, në tryezat tona dhe në eksporte.

Pjesë e Skemës Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësisë është edhe masa e naftës falas për fermerët, për të cilën janë akorduar 1.4 miliardë lekë dhe që funk-



miliardë lekë, i ndarë në disa sektorë prioritarë, që prek çdo hallkë të zinxhirit të prodhimit

sionon me të njëjtën procedurë aplikimi për t'u përfituar si ajo e vitit të kaluar.



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



**MBËSHTETJE FINANCIARE
PËR TË GJITHË FERMERËT**

**KREDI E DEDIKUAR
PËR MBJELLJEN E GRURIT**



GRATË NË SIPËRMARRJE

Mozaik i jetës rurale - Historia e Florës nga Puka

“E dua fshatin por nuk më pëlqen që njerëzit nuk janë vetvetja, nuk arrijnë dot të marrin një vendim të lirë, pa u ndikuar nga të tjerët”.

Flora është kryefamiljare. Humbja e bashkëshortit e ka

Flora ka arritur të sfidojë mentalitetin dhe të krijojë ardhura të qëndrueshme për familjes e saj.

“Unë punoj si infermiere këtu në fshat, por kisha nevojë

me njerëz të ndryshëm, filloi të merrte veten dhe kjo e ndihmoi që të punonte akoma më shumë. “Pjesëmarrja në trajnime jo vetëm më mësoi teknika dhe metoda për përpunimin e lëngjeve dhe rec-

ngasësh, merr makinën dhe ec vet.”

Prej shume vitesh Flora i shërben vetes dhe punës së saj. Ajo udhëton për më shumë se një orë sa herë që është nevoja të shkojë në Pukë për t'u takuar



detyruar të përplaset e vetme me shume sfida në fshatin e saj Kimëz, në Pukë. Flora tregon se në fillim ka punuar çdo punë që mund të bënte për të siguruar të ardhura, që nga infermiere e deri tek shitëse në një kioskë në fshat. E pavarësisht vështirësive, e gjitha çka ajo kërkonte ishte mbështetja që i mungonte nga rrethi shoqëror. Këtë mbështetje Flora e gjeti tek shoqëria civile ku ajo u aktivizua vazhdimisht

për një shoqëri dhe një pasion që të më bënte të ndihesha e gjallë, sepse atëherë isha futur diku në një errësirë. Në fillim kisha shumë frikë, por njerëzit që më njihnin më nxisnin vazhdimisht. Ndonjëherë i thoja vetes se tani jam kryefamiljare dhe kam kohë të merrem me këto punë, megjithatë, e nxitur pak nga njerëzit dhe pak nga dëshira ime, u njoha me Agro-Pukën dhe kështu nisi “Zojat e Munellës”.

celërave të boronicës, mjedrës, manaferrave dhe frutave të tjera, por mbi të gjitha më ndihmoi shpirtërisht. Më ndihmoi të rigjeja forcën për të ecur përprapa. Kisha dëshirë edhe që t'i jepja mundësinë edhe grave të tjera të zonës për kultivimin, grumbullimin dhe përpunimin e frutave të egra.”

me grupin e zonjave, për trajnime apo aktivitete rekreative. Ndjek çdo panair në Tiranë apo qytete të tjera. *“Unë vet shkoj pothuaj në të gjitha aktivitetet, iu them dhe shoqeve por shpesh nuk vijnë, madje bashkëshortët iu thonë mos rritni me Florën. Arsyja e vërtetë që mendoj unë pse nuk i lënë është se nuk duan që gratë e tyre të marrin pavarësi ekonomike dhe kjo nuk i intereson burrave. Është shumë*



me trajnime, vizita studimore dhe rritje kapacitetesh. Sot,

Flora thotë se duke qenë në kontakt me shokë e me shoqe,

që Flora duhej të tejkalonte. *“I thash vetes Flora, ti di ta*

e vështirë por duhet dikush që ti thyej këto gjëra.”

Pak ditë më parë, Kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe Ministria e Bujqësisë prezantuan tregun e ri agroushqimor në Farkë, të quajtur “Agro Park Tirana”.

Gjatë viteve të kaluara, bujqësia shqiptare ka vuajtur nga mungesa e tregjeve të mirorganizuara për produktet bujqësore vendase. Jo rrallë herë, nismat dhe investimet shtetërore për mbështetjen e tregjeve bujqësore kryheshin jo në pika nevralgjike dhe përfitimi i fermerëve ishte minimal.

Rritja e konkurrencës nga tregjet e huaja dhe dobësimi i lidhjeve të fshatit shqiptar me industrinë përpunuese në vend, sollën, krahas izolimit të disa krahinave të vendit, të njohura për kulturat e tyre bujqësore, edhe një nivel të ulët e të pakënaqshëm të të ardhurave të realizuara nga fermerët për produktet e tyre. Për shumë vite në të kaluarën, mungesa e tregjeve bujqësore të organizuara ka rezultuar në një zhvillim kaotik dhe jo rezultativ të bujqësisë sonë.

Tregjet e mirorganizuara të produkteve shqiptare, si “Agro

Park Tirana” janë organizma të mirëpritura nga opinioni ynë publik dhe nga specialistët e fushës, por janë edhe të domosdoshëm, pasi ato do ta orientojnë, mbrojnë dhe zhvillojnë prodhimin tonë bujqësor bio, si dhe do të rregullojnë tregun agrar të vendit. Ndërtimi dhe përmirësimi i tregjeve sjell bashkimin në një vend fizik, me standarde të larta, të agropërpunuesve, të grumbulluesve, të shitësve të lëndëve të para bujqësore, të institucioneve shtetërore, këshilltarëve, agronomëve të shtetit, të cilët do të jenë në këto tregje, së bashku me ekspertët të fushës të institucioneve financiare, si bankat dhe shoqatat e mikrokredisë.

Këto parqe do të shndërrohen shumë shpejt në djepe të projekteve të ndryshme zhvillimore, të cilat gjithashtu do të zbatohet aty dhe kudo ku ka bujqësi tek ne. Nga ana tjetër, qytetarët-konsumatorë, që do të duan të kalojnë një të shtunë ose të dielë ndryshe, mes prodhuesve, për të kuptuar se

si vjen ushqimi në tryezat e tyre, si rriten bimët, mund t'ua mësojnë këtë fëmijëve të tyre, në një vizitë gati piknik në parkun bujqësor, pavarësisht se blejnë mallra.

“Agro Park Tirana”, ky treg i madh i bashkuar, përmban disa avantazhe. Përmban dobi për vetë fermerët, pasi ul kostot e tyre të prodhimit, Fermerët do të kenë mundësinë që aty t'i blejnë lëndët e para më lirë, sepse do t'i marrin direkt nga dora e parë e tregtarëve. Do të kenë mundësinë të rrisin shitjet e prodhimeve të tyre, duke krijuar dalëngadalë një ekonomi shkalle, pasi duke u bërë bashkë në këtë treg, ata do të kuptojnë që është më mirë që të prodhojnë një bimë të caktuar: për shembull specin, domaten, etj., sepse kështu e kërkon edhe tregtari, jo vetëm për ta shitur në këtë treg, por edhe për ta eksportuar atë në tregje ku ka më shumë kërkesë.

Ky treg ndërtohet jo vetëm për konsumatorët e Tiranës, që është tregu më i madh që kemi

në Shqipërinë, por është një treg që do të marrë produkte edhe nga Elbasani, Dibra, por edhe nga Korça e Divjaka. Vendndodhja strategjike në Farkë nuk është zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga Bashkia Tiranë dhe Ministria e Bujqësisë. Është zgjedhur për të çliruar gjithë atë vëllim produktesh që prodhohen nga Elbasani, nga Shkodra, nga Dibra, duke u dhënë qasje praktikisht të gjithë fermerëve të Shqipërisë.

“Agro Park Tirana” është një pikë takimi e tyre. Njëpërmjet një infrastrukture të tillë, me standarde mjaft të larta edhe të sigurisë ushqimore, me kapacitete frigoriferike, ku produkteve mund t'u shtohet vlera edhe përmes përpunimit, krijohet mundësia të garantohet siguria ushqimore për konsumatorët, duke ulur koston e prodhimit dhe rrjedhimisht edhe çmimin për ta.

Ky park bujqësor do të ofrojë një sistem transparence për produktet që do të shiten në këtë treg. Njëlloj sikurse

Si të gesh partnerë biznesi jashtë vendit për të eksportuar

(Vijon nga faqja 6)

edhe jashtë saj. Ata mund të jenë një burim i pasur idesh dhe kontaktesh. Shih nje liste permbledhese te tyre ne Shqiperi <http://sipermarraime.gov.al/shoqatat>

- Kërkoni këshillangakëshilltarët në Dhomën e Tregtisë së rajonit apo ne qytetet tuaj p.sh ne Tirane (DHTI) <https://www.cci.al/> si dhe ne Agjencinë Shqiptare te Investimeve te Huaja (AIDA) <https://www.aida.gov.al/sq/nvm/zgjeroni-tregun-tuaj>.

- Kontakti me Enterprise Europe Network (EEN-Albania - <https://www.een.al>). Ato ofrojnë, ndër të tjera, akses në një bazë të dhënash të partnerëve të biznesit, me profile të mijëra kompanive nga rreth 60 vende. Ju gjithashtu mund të plotësoni profilin tuaj.

- BalkanMed - Regjistruhu për lidhje, bashkepunime biznesi me BalkanMed -<https://www.bmbpages.biz/companies/listall> që ofron informacion mbi shoqatat dhe grupimet e kompanive të SME-ve eksportuese per rajonin. BalkanMed eshte një platformë biznesi që lidh dhomat ballkanike të tregtisë për mbi 6 vende, përfshirë Shqiperine, etj.

- PanaiRET Tregtare - Vizitoni panaiRET dhe ekspozitat tregtare ndërkombëtare (shih listen e panaiREve dhe Bazen e të dhënave per to (<https://www.tradefairdates.com/>) dhe kontakto me klientët e mundshëm. Agjencia Shqiptare te Investimeve te Huaja - AIDA , Programi Zvicerian i Promovimit të Importeve (SIPPO) dhe Rrjeti Evropian i Ndërmarrjeve – ENN. ofrojne asistencë dhe organizojne ture studimore, takime B2b, dhe

pjesemarrje në ekspozita tregtare ndërkombëtare, misione blerjeje apo eksportuesve. Për më shumë informacion shihni në: <http://www.s-ge.com/switzerland/import/en> dhe <https://www.sippo.al/>

- Organizatat ndërkombëtare, si Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB)- <https://albania.un.org/sq/sdgs/8> edhe BE-ja ose shpesh kërkojnë furnizues; zbuloni nëse mund të ofroni shërbimet tuaja. Platforma Access2Markets është një platformë qendrore në internet e zhvilluar nga BE , e cila përfshin informacione si për importuesit ashtu edhe për eksportuesit, potenciale eksporti, tarifatat dhe barrierat tregtare, rregullat doganore , etj, në mënyrë të shpejtë. <https://trade.ec.europa.eu/access-to-markets/en/content/welcome-access2markets-trade-helpdesk-users#toc>

- Platforma b2b për shitje ndërkombëtare. Europages ofron zgjidhje B2B e-marketing për kompanitë që dëshirojnë të përmirësojnë dukshmërinë e tyre në internet dhe të gjenë partneritet biznesi. Shih Europages <https://www.europages.co.uk>. Gjithashtu ne Shqiperi, Platforma B2B online per NMV- te - <http://aida.gov.al/b2b/en/b2b/>

- Qendra Hollandeze për Promovimin e Importeve (CBI) - Përdorni shërbimet e ofruara nga Qendra (CBI Holland)- <https://www.cbi.eu/market-information> që lidh bizneset nga vendet në zhvillim me partnerët e mundshëm të biznesit evropian duke ofruar informacion të pasur dhe këshilla praktike për mënyrën se si mund të hyhet në tregjet europiane.

"Agro Park Tirana" dhe e ardhmja e bujqësisë

ekziston bursa bujqësore jashtë vendit, për shumë prej produkteve ushqimore që do të shiten në këtë park, do të ketë një minibusë, ku fermerët do të njihen me çmimet që ofrohen në rang vendi.

Tregu do të ketë një tabelë elektronike të çmimeve, e cila do të përditësohet në kohë reale. Fermerët do të dinë, sipas kërkesës dhe ofertës, se ku rrahin çmimet, duke evituar abuzimet e shumta që bëheshin në të kaluarën me mungesën e dijeve nga fermeri, për konjukturën reale të tregjeve të produkteve që ata shisnin.

Ky sistem transparence e bën më konkurrues tregun e produkteve bujqësore në Shqipëri, duke ulur kostot tregtare të shërbimit si për fermerin dhe për konsumatorin, si dhe duke informuar pjesëmarrësit në treg jo vetëm për çmimin, por edhe për origjinën nga ka ardhur produkti.

Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural po krijojnë një traditë të mirë në marketimin

e produkteve bio dhe me vlerë për të gjithë vendin, si domatja e vonë e Shëngjergjit, gjeli i Baldushkut apo ulliri i Ndroqit, traditë, e cila pritet të ndiqet edhe nga bashkitë e tjera, pasi gama e produkteve bujqësore dhe blegtorale me emër të mirë është shumë e gjerë. Janë 55 mijë m2 në dispozicion të fermerëve tanë. 100 përqind e sipërfaqes për fermerët dhe tregtarët e produkteve bujqësore është tashmë e prenotuar prej tyre.

Bashkia e Tiranës po mendon ta zgjerojë dhe dyfishojë shumë shpejt këtë hapësirë. “Agro Park Tirana” është një treg i ndërtuar posaçërisht për fermerët, të cilët mund të shesin produktet e tyre me zero taksa, ndërsa konsumatorët do t'i blejnë më lirë prodhimet bio, të kontrolluara dhe të certifikuar sipas standardeve europiane. Në të ardhmen, pa dyshim që ky treg do të ndiqet nga investimi i bashkive tona kryesore dhe i qeverisë qendrore në shumë tregje të tjera në pika nevralgjike, si në Lushnjë (Divjakë), Vlorë, Shkodër e Korçë.

Fatos Çoçoli

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE SHKODËR

Hibridet e misrit nuk zgjidhen nga popullariteti. Është e rëndësishme të mendoni për qëllimin, nëse do të përdoren për kokërr apo silazh.

Në zgjedhjen e hibridit të përshtatshëm duhet të keni parasysh dhe të njihni kushtet agro-ekologjike të rajonit tuaj. Këto janë faktorë përcaktues në përzgjedhjen për hibride që sjellin rendimentet më të mira në ato kushte. Para së gjithash, vëmendje duhet t'i kushtohet grupit të pjekjes. Dhe në këtë rast prioritet duhet ti japim faktorit thatësirë që janë gjithnjë e më të shpeshta pikërisht në kohën kur misri kalon në fazat kritike të zhvillimit (Xhufkim, dalja e mustaqeve dhe pjalmim).

Një këshillë tjetër për kultivuesit me sipërfaqe të mëdha. Në këtë rast rekomandohet përdorimi i grupeve të ndryshme të pjekjes, në mënyrë që të reduktohet rreziku dhe rritet rentabiliteti. Edhe në rast të thatësirës, disa grupe të pjekjes do të kenë kushte më të favorshme për pjalmim dhe fekondim.

Nëse fermeri vendos vetëm për hibridet e vonshme, ndodh që për shkak të kushteve të paparashikueshme të motit, ato të mos piqen në kohë, gjë që çon në rritjen e lagështirës në kokërr. Në këto raste korra e mekanizuar shtyhet në kohë, koston e tharjes e të ruajtjes rriten, shfaqen sëmundjet e kallirit, infeksionet nga mykotoksina shtohen. Nga ana tjetër, gjeneratat e reja të hibrideve të mesëm ose gjysmë të vonë iu afruan rendimentit të hibrideve me pjekje të vonshme.

Ndër karakteristikat e hibridit që duhet t'i kushtohet vëmendje janë shpejtësia e

KËSHILLA PËR FERMERËT
SI TË ZGJIDHNI HIBRIDIN MË TË MIRË TË MISRIT

lëshimit të lagështirës nga kokrrat, lartësia dhe qëndrueshmëria e kërcellit si dhe rezistenca ndaj sëmundjeve. Po kështu, është e rëndësishme të dini paraprakisht se cila do të jetë kultura e ardhshme në sistemin e qarkullimit bujqësor, në mënyrë që të ketë kohë të mjaftueshme për të përgatitur parcelat në kohë.

Kultivimi i misrit për silazh

Në vendin tonë, ashtu sikundër në shumë vende të rajonit e me gjerë, kultivuesit e misrit para se gjithash synojnë në realizimin e prodhimeve të larta të kokrrave të kësaj kulture. Përveç kësaj, misri rritet edhe me qëllim të përdorimit të tërë bimës së tij, më së shpeshti në formën e silazhit ose produkteve të caktuara të dehidratuara (si p.sh. mielli nga e gjithë bima e misrit, briketa, etj.).

Cilat janë specifikat e kultivimit të misrit për silazh

Përgatitja dhe përdorimi i silazhit është i zakonshëm në kushtet e fermave që mbarëshojnë kafshë, në veçanti komplekset e gjedhit për qumësht apo mish, është më i thjeshtë dhe nuk ka kosto për tharje. Ka shumë arsye për një zhvendosje më të dukshme në vitet e fundit drejt rritjes së sipërfaqeve të misrit për

silazh. Më e rëndësishmja ndër to është se me misër nga një hektar, nëse bimët e tyre përdoren në formën e silazhit të përgatitur mirë, mund të prodhohen 300-500 kilogramë "mish" më shumë sesa nëse përdoret si drithë (koncentrate kokërr). Silazh mund të bëhet nga shumë bimë të tjera, nga Sorgumi, tritikalet ose elbi. Edhe në këto raste përgatitet silazh i cilësishëm së mirë. Megjithatë, fermerët preferojnë të zgjedhin silazhin e misrit. Arsyeja kryesore për këtë është se një hektar misër i korrur për silazh jep më shumë lëndë ushqyese totale dhe lëndë të thatë sesa nga kultivimi i sorgumit, tritikaleve, elbit apo ndonjë kulture tjetër.



Specifikat e kultivimit të misrit për silazh

Rendimenti i misrit duhet të shprehet përmes sasisë së njërive ushqyese për ha, dhe jo në formën e kilogramëve, metra kub apo tonelatat e masës së gjelbër, siç ndodh më shpesh. Misri për silazh kultivohet pak a shumë në të njëjtën mënyrë si misri për kokërr. Ndryshimet kryesisht i referohen zgjedhjes së hibrideve, mbjelljen e një numri më të madh bimësh për njësi sipërfaqe, doza plehërimi më të mëdha dhe sigurisht afatit të vjeljes.

Sai përket zgjedhjes së hibrideve, duhet thënë se ka hibride që janë të përshtatshëm specifikisht për marrjen e masës sa më të madhe për silazh. Gjithashtu, një hibrid i karakterizuar nga rendimenti i lartë i drithit mund të jetë i mirë edhe për

silazhin, sepse kokra në fakt përmban pjesën më të madhe të totalit të njërive ushqyese. Por jo gjithmonë është kështu. Tipi i hibrideve "stay green", me kapacitet të lartë në prodhimin kokërr janë më të mirë në përdorimin e tyre për silazh. Meqenëse misri për silazh korret në kohën e pjekurisë së plotë dylli, kur zgjidhni hibride për silazh, mund të zgjidhni hibride pak më të vonshëm. Ato mund të

jenë pak më vonë se hibridet që rriten për kokërr në rajonin e caktuar.

Për sqarime të tjera kontaktoni: Mob: 0693100694

Drejtorja e Teknologjive Bujqësore, QTTB-Shkodër,
E-mail e-mail: imoshkoder@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE LUSHNJE

MESAZHE PËR PRODHUESIT E PERIMEVE
MARS 2023

Muaji Mars karakterizohet nga temperatura mesatare dhe kujdesi për perimërritësit në bujqësi duhet të jetë i madh. Punohet me përgatitjen e serrave që janë pa mbjellë si dhe kujdesi për ato që janë mbjellë gjatë muajve të mëparshëm. Punohet për mbjelljen e farave në farishte e me përgatitjen e fidanëve për perimet e fushës; ndërkohë që vazhdon puna për përgatitjen e ngastrave, me plugimet, plehërimet bazë, hapjen dhe mbajtjen në funksion të plotë të rrjetit kullues të ngastrës, etj. Po vazhdohet dhe me kryerjen e shërbimeve të tjera si kullim. Pra është periudhë shumë intensive me punë, ku sipas drejtimit të fermës mbillen serra, vazhdojnë shërbimet për kulturat e mbjella si në serra ashtu dhe në fushë, përgatiten ngastra në fushë për mbjellje, vilet prodhimi i gatshëm.



që konsiston në shërbimet në serra të mbjella me domate, trangull, spec, patëllxhan, pjeper, mashurkë, etj. Duke qenë se muaji Mars karakterizohet nga lagështi e lartë në serra duhet ruajtur si niveli i lagështisë ajrore ashtu dhe ai në tokë. Duhet ajrosur serrat

mirë që mos të kemi kalbëzime, botritis, vrugje, hire etj. Sot në serra fidanet e perimeve ndodhen në faza të ndryshme që nga ato sapo mbjellë deri tek fidanët e rritur që kanë filluar procesin e lulëzimit dhe lidhjes së kokrrave, disa të tjera në vjelje. Edhe kujdesi ndaj kulturave të mbjella në serra duhet të bëhet sipas fazave aktuale që ndodhen fidanet si ujitje, plehërim, spërkatje, përdredhje, krasitje, etj.. Disa serra aktualisht janë mbjellë me disa bimë dimërore, si sallatë, spinaq, erëza, etj., ku puna me ato vazhdon për kryerjen e shërbimeve e vjeljet.

Në fushë: Në bimët e mbjella në verë e vjeshtë, si lakra kokë, lule lakra, brokoli, karota, prasi, qepa, hudhra, etj., vazhdohet me vjeljen e tyre.

Në fushë në zonën e ultësirës perëndi-

more ka filluar e vazhdon mbjellja e bizeles, patates, spinaqit, etj. Me farën e patates puna ka filluar më herët, duke bërë bulëzimin e saj në mjedise të ngrohta, si hangarë, tunele, etj.

Në zonën e ngrohtë ka filluar dhe duhet të vazhdojë puna për përgatitjen e mbjelljen e shalqinit me tunele, ku ka nisur puna për përgatitjen e tokës. Plugimi është bërë më herët, vazhdon puna plehërimin bazë, me frezim, shtrirjen e rrjetit ujitës, milcerim dhe në fund mbjellja dhe mbulimi me plastmas transparent. Në parcelat ku ato që do mbillen, të tregohet kujdes për kryerjen e analizave kimike të tokës për të bërë bilanc të ushqyerit të bimëve për ruajtjen e pjellorisë së tokës dhe mirëmbajtjen e saj. Veçanërisht në këtë stinë reshjesh, krahas punimit të mirë të tokës, të tregohet kujdes për kullimin, i cili jo vetëm mbron tokën nga erozioni e dëmtimi, por dhe lejon kryerjen e shpejtë të punimeve përgatitore e të mbjelljeve të hershme.

Për perimet e hershme në fushë, gjatë muajit Mars të fillojë puna me mbjelljen e farërave në farishte dhe përgatitjen e fidanëve për prodhim të hershëm të domates, specit, patëllxhanit, pjeprit, sallatës, etj.

Aktivitetet kryesore të kësaj periudhe?

Në serra: Me rëndësi është puna

Drejtorja e Teknologjive të Perimeve: QTTB-Lushnje
E-mail: qttblushnje@yahoo.com

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUIJË

Mbarështimi i gjelit të detit përbën një aktivitet të rëndësishëm në vendin tonë. Ai është burim të ardhurash për ekonominë dhe familjet që i mbarështojnë këto shpendë. Gjeli i detit është specie me rritje të shpejtë, një



konvertues i shkëlqyer i ushqimeve në mish të cilësisë së lartë dhe me kosto krahasimshme të ulët me speciet e tjera. Mbarështimi i gjelit të detit po vlerësohet nga fermerët si një biznes i vogël apo i mesëm në kushtet e trajtimit ekstensiv dhe gjysëm intensiv, duke zbatuar hollësisht të gjitha hallkat teknike e teknologjike me bazë sa më shkencore, duke bërë që të rriten të ardhurat e këtij biznesi blegtoral. Mishi është i shijshëm ka vlera të larta ushqimore është i pasur me proteina dhe përbërës të tjerë ushqimor si vitamina të grupit B. Ky bën pjesë në grupin e mishrave dietikë dhe është ushqim i përshtatshëm për të gjitha moshat. Përdorimi i tij nuk ndikon në rritjen e kolesterolit në gjak. Prodhimi dhe konsumi i mishit të gjelit të detit po rritet shumë në vendin tonë.

Mbajtja e gjelit të detit në ferma të vogla familjare ose e thënë ndryshe mbajtje tradicionale, jo vetëm në vendin tonë por edhe në vendet e tjera ka disa përparësi:

- Është burim i mirë të ardhurash për familjet në zonat rurale;
- Siguron mish të freskët e në cilësinë e kërkuar;
- Krijon mundësi në punë të përfshirjes në familje;
- Kërkon paisje të thjeshta e teknologji të thjeshta jo të kushtueshme;
- Racat e vendit autoktone janë raca me përshtatshmëri të mirë si në drejtim të aklimatizimit, ashtu edhe të sëmundshmërisë;
- Mbarështohen në kushte ekstensive dhe gjysëm/intensive.
- Shfrytëzojnë mirë kullotën;
- Këto mbajnë gene që janë rezistente.
- Arsyet e rritjes së prodhimit dhe njëkohësisht

Mëshqerrat duhen trajtuar me kujdes sepse suksesi i ripërtëritjes së tufës dhe prodhimtarisë lidhet me shfrytëzimin efektiv të tyre.

Çdo vit përzgjidhen si remont rreth 25% e tufës. Kujdesi i veçantë për mëshqerrat duhet të tregohet për mjedisin dhe hapësirën ku ato mbahen, i cili duhet të jetë i bollshëm dhe në varësi të racës, peshës dhe moshës. Temperatura e cila duhet të jetë optimale dhe në përputhje me stinën.

Përbërësit kryesorë të ushqimit të mëshqerrave janë proteinat dhe mineralet, të cilat sigurojnë kondicionin e duhur trupor. Uji të jetë i pastër, i freskët dhe pandërprerje dhe të ndiqen me kujdes dhe rigorozitet programi shëndetësor i tyre.

Kujdesi i veçantë duhet treguar për mbarështimin e mëshqerrave pasi të arrijnë pjekurinë seksuale dhe ekonomike. Në këtë kohë duhet të fillojë vrojtimi i ciklit estral dhe sidomos shfaqja e afshit, pasi lidhet me suksesin e inseminimit artificial (IA). Mëshqerrat barse, deri 3-4 muaj para pjelljes mbarështohen njëjloj si dhe para inseminimit, më pas kujdesi dhe trajtimi duhet të jetë si për lopët në periudhën e tharjes.

Të ushqyerit gjatë kësaj periudhe ndikon në

EFEKTI I PËRDORIMIT TË USHQYERIT TË BALANCUAR TË GJELIT TË DETIT NË SISTEMIN EKSTENSIV

edhe konsumit të mishit të gjelit të detit janë:

Së pari: Kjo specie ka rendiment të lartë mishi; Së dyti: Prodhon mish me cilësi të mirë (reze të lartë, raport të përshtatshëm mish x kocka, % të lartë të muskulaturës, sidomos asaj të gjoksit, % të lartë proteine, përmbajtje të ulët të yndyrës dhe tretshmëri të lartë.

Së treti: Kosto e ulët në prodhimin e mishit, e si rrjedhojë e shpërbimit të mirë të ushqimit.

Vitet e fundit është rritur shumë numri i fermerëve, që merren me rritjen dhe mbarështimin e gjelit të detit.

Teknologjia e të ushqyerit të zogjve të gjelit të detit

Të ushqyerit është një faktor shumë i rëndësishëm për të shfrytëzuar në mënyrë sa më të plotë aftësitë prodhuese të shpendëve, në këtë rast për



gjelin e detit, për të marrë prej tyre prodhime të larta mishi me kosto sa më të ulët. Shpenzimet për ushqimin përbëjnë 70 % të kostos totale të mbajtjes së tyre. Është e rëndësishme që shpendët të tresin dhe të shfrytëzojnë në mënyrë sa më efektive ushqimet, lëndët ushqyese të racionit të tyre.

Gjelat e detit janë specie me volum të vogël të aparatit tretës. Ato preferojnë përzjerje të ushqimeve të koncentruara e të balancuara. Racionet e balancuara përmbajnë burime të mjaftueshme të të gjithë lëndëve ushqyese të njohura, duke siguruar kështu një prodhim maksimal. Të ushqyerit e gjelit të detit duhet të trajtohet sipas moshave të rritjes: 0-8 javë, e 8-16 javë me nivel proteinik 28 %, 20 % - 21%, për të përmirësuar treguesit teknik, produktiv dhe ekonomik. Periudha nga çelja e zogjve deri në 16 javë është nga më të vështirat për rritjen e gjelit të detit. Kërkon kujdes në plotësimin e bilancit ushqimor me proteina, korbhidrate vitamina e kripëra minerale e mikroelemente.

KUJDESI DHE TË USHQYERIT E MËSHQERRAVE

zhvillimin e përgjithshëm trupor, në prodhimtarinë e ardhshme dhe varet nga dy faktorë:

- 1) nga moshja kur mëshqerra do të hyjë në prodhim;
- 2) nga cilësitë e foragjereve që disponohen.

Koha e ndërzimit duhet të përcaktohet nga peshja (380-480 kg peshë trupore) dhe jo nga moshja. Mëshqerrat e ndërzyera me vonesë, shpesh herë kanë pjellori shumë më të ulët se mëshqerrat që janë ndërzyer më herët. Mëshqerrat duhet të ndërzyhen për herë të parë në moshën 14-16 muajshe. Përgatitja e mëshqerrave për ndërzim fillon me përmirësimin e të ushqyerit të tyre 3-4 javë para dhe zgjat 3-4 javë pas ndërzimit. Të ushqyerit organizohet sipas moshës së tyre. Nga moshja 4-12 muajshe, sasia e sanës dhe koncentratit zvogëlohet ndërsa rritet prania e ushqimit të gjelbër ose silazhit. Pas moshës 12 muajshe, gradualisht futen ushqimet vëllimore të cilat sigurojnë një shtesë mesatare ditore

Rezultatet e larta në rritjen e gjelit të detit varen nga:

- Raca;
- Përshtatshmëria ndaj kushteve të mbarështimit;
- Plotësimi i nevojave me lëndë ushqyese në përputhje me fazat e rritjes;
- Kujdesi i rritësve, menaxhimi i mirë tufës

Prodhimi i mishit është në varësi të të ushqyerit

Sasia e ushqimit që ato marrin varet nga kërkesat që kanë për lëndë ushqyese. Këto kërkesa varen direkt nga masa trupore, moshja, raca dhe nga niveli i prodhimtarisë së shpendëve.

“Efekti i përdorimit të ushqyerit të balancuar të gjelit të detit në sistemin ekstensiv”

Sistemi ekstensiv i mbarështimit të gjelave të detit karakterizohet nga inpute të ulta në drejtim të menaxhimit dhe investimeve. Në mbajtjen



familjare, mbarështimi bëhet në formë ekstensive mbështetur në traditën shekullore të mbajtjes, kryesisht në kullotë, në strehime të papërshtatshme. Numri i krerëve për familje arrin 50-200 krerë. Të ushqyerit ndikon në arritjen e një mbarështimi të mirë dhe rezultate pozitive në gjendjen shëndetësore të tufës. Ushqimi duhet të përdoret me norma teknike sipas moshës. Racionet e gjelit të detit duhet të jenë të plota të balancuara, të pasura me proteina, lëndë minerale, mikroelemente duke mbajtur parasysh konsumin ditor të tufave në kushtet e mbajtjes së tyre. Gjeli i detit është një shpend që shndërron me rentabilitet ushqimet në mish.

Për të provuar ndikimin e efektit të përdorimit të ushqimit të balancuar të gjelit të detit kemi realizuar një studim në zonën e Baldushkut, e

cila ndodhet në jug të Tiranës. Baldushku është një zonë me traditë dhe me përvojë në mbarështimin dhe rritjen e gjelit të detit.

Në kërkim u përfshinë 2 ferma private, që mbarështojnë një numër prej 120 dhe 150 krerë gjela deti.

Treguesit që u studiuhan:

Pesha trupore, uniformiteti, shtesa e peshës, rrezja e mishit (%), vitaliteti, shpërbliimi i ushqimit, moshja, pesha e therjes dhe kosto e prodhimit të mishit.

Rezultatet	Kontrolli	Eksperimenti
Pesha trupore në therje - (Pula)	4-4.5 kg	5-6 kg
Pesha trupore në therje - (Gjeli)	7-8 kg	9-10kg
Moshja e therjes	8 muaj	7 muaj
Uniformiteti	85%	89%
Shtesa e peshës	150 gr	250 gr
Rrezja e mishit - (Pula)	72%	76%
Rrezja e mishit - (Gjeli)	78%	80%
Vitaliteti (ngordhjet)	7,5%	5%
Shpërbliimi i ushqimit	3%	2.5%
Kosto e mishit	490 lekë/kg	409 lekë/kg

Fermerët e kësaj zone kanë fituar përvojë në përzgjedhjen e remontit, në rritjen e trajtimit sipas fazave të rritjes, duke u kujdesur për përdorimin e ushqimeve dhe për profilaksin kundër sëmundjeve infektive e parazitare. Kjo përbën një aktivitet të rëndësishëm për familjet e këtyre zonave.

Përfundime:

Me përdorimin e racioneve ushqimore të balancuara tek gjeli i detit u arrit:

- Rritja efektivitetit të prodhimit dhe përmirësimi i treguesve teknik;
- Realizimi i një të ushqyeri të plotë dhe të balancuar me vlera energjitike, proteinike e mineralo-vitaminike;
- U reduktua masa e dëmtimeve deri në 1,5 % dhe u ul kosto e prodhimit të mishit.

Mishi i gjelit të detit renditet ndër më të mirët nga vlera proteinike e aminoacidike.

e domosdoshme që në racionin ushqimor të mëshqerrave të përfshihet një sasi koncentratesh (0,5-0,9 kg/krerë/ditë kur përdoren ushqime vëllimore të cilësisë së dobët). Futja e koncentrateve në racion bëhet gradualisht dhe me po ato kritere si për lopët në tharje. Pavarësisht nga këto, sasia e koncentrateve që mund të përdoret varet nga gjendja shëndetësore e mëshqerrës. Kur është në kondicion majmërie nuk ka përse të përdoren ushqime të koncentruara, pasi kjo është antiekonomike dhe mëshqerra të tilla pjellin me vështirësi, prodhojnë më pak qumësht dhe kanë jetëgjatësi më të shkurtër produktive.

Në përgjithësi kjo periudhe nuk shfaq probleme me të ushqyerit, por në të njëjtën kohë nënvlerësohet më shumë sepse këto kafshë konsiderohen si joprodhuese, e për rrjedhojë nuk u kushtohet kujdesi i duhur. Nga ana tjetër, për qëllime ekonomike, duke respektuar gjendjen fiziologjike dhe zhvillimin e mjaftueshëm trupor, synohet që mëshqerrat të futen sa më shpejt në prodhim, prandaj kjo periudhë duhet reduktuar sa më shumë, gjë që varet kryesisht nga të ushqyerit optimal.

Përgatiti: Flamur Shabani, Albi Shehu

Drejtorja e Teknologjive Blegtorale: QTTB-Fushë Krujë
mail:qttbfushekruje@yahoo.com

KËNDI I EKSPERTIT

Kalendari bujqësor, muaji prill 2023

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

Pamja e qiellit gjatë muajit prill 2023

Më 6 Prill - Hëna e plotë. Hëna do të jetë e vendosur në anën e kundërt të Tokës si dhe

minuta ditë dhe dita më e gjatë do të jetë 30 Prilli me 13 orë e 57 minuta ditë.

Për referencë, më 21 qershor, dita më e gjatë e vitit, Dielli lind

Parashikimi i motit për muajin prill 2023 në Tiranë (Zona bregdetare)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Zhvillimi i reve dhe reshjet	Simboli
	U	L		mm	Orë	Km/Orë		Drejtimi				
	D	N		D	N	D	N					
1	9	16	9/16/2015	5.1	3	9	6	VL	LVL	1	Periudhë me shira	
2	8	16	7/18/2016	5.2	4	6	4	VL	LVL	2	Kryesisht me re me ndonjë reshje vënde-vënde	
3	8	17	6/17/2016	1.9	2	9	15	VL	VL	1	Vranësira me ndonjë pikë shiu	
4	7	16	5/16/2015	0	0	9	13	VL	VL	2	Vranësira	
5	7	17	6/17/2016	0.8	1.5	13	9	LVL	VL	2	Mbetet me re; shi në mëngjes në pika i ndjekur nga pak shi pasdite	
6	8	16	7/19/2016	0	0	9	7	VL	VVL	6	Interval re dhe kohë me diell	
7	7	17	8/20/2016	0	0	9	7	VL	VVP	6	Diell dhe pak re	
8	7	17	8/22/2016	0	0	7	7	LVL	V	6	Kryesisht me diell	
9	8	17	8/22/2017	0	0	7	6	JUL	JUL	6	Pjesërisht me diell	
10	8	17	7/18/2017	3.2	3.5	9	7	JL	JUL	2	Vranët; shi në mëngjes në pika të i ndjekur nga pak shi pasdite	
